



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 28 KORRIK 2011

T R A N S K R I P T

SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
28. JULA 2011. GODINE

KORRIK – JULI
2011

E enjte, 28.7. 2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Para se të fillojmë me punën, në nderim të Heroit më të ri të Kosovës, Enver Zymberi, shpall një minutë heshtje.

Lavdi Heroit, Enver Zymberit!

Në mbledhje janë të pranishëm 77 deputetë, që do të thotë se mund t'ia fillojmë punës.

Në fillim, ia kisha dhënë fjalën kryeministrit, zotit Hashim Thaçit.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar kryetar Krasniqi,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,

Me lejon që t'ju informoj juve dhe qytetarët e Republikës së Kosovës lidhur me zhvillimet e fundit në veriun e Kosovës.

Definitivisht, Kosova është duke iu ofruar momentit të përmbylljes me sukses të pavarësisë së mbikëqyrur. Misioni thuaj se i pamundur 12 vjeçar për vënien e rendit dhe ligjit në veri të Kosovës, tani po bëhet i mundur dhe realitet nga institucionet e shtetit të Kosovës.

Siç jeni në dijeni, Qeveria e Republikës së Kosovës, javën e kaluar, duke respektuar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, ka marrë vendim për aplikimin e masave të reciprocitetit për mallrat që janë importuar nga Serbia dhe Bosnja Hercegovina.

Natyrisht, ky vendim ka filluar të zbatohet në të gjitha pikat kufitare menjëherë, në përjashtim të pikës 1 dhe 31.

Për rrjedhojë, unë si kryeministër kam autorizuar Policinë e Kosovës, që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për vendosjen e sundimit të ligjit dhe zbatimin e vendimit për reciprocitet në pikën 1 dhe 31. Vendimi nuk ka qenë i lehtë, ka qenë i rëndë, por i drejtë, kushtetues edhe ligjor.

Policia e Kosovës ka filluar operacionin dhe pas përfundimit me sukses të njësisë speciale në veri të vendit, ato janë tërhequr dhe Policia Kufitare dhe doganieret janë vendosur në pikën 1 dhe 31, për ta kryer punën e tyre normale të kontrollit kufitar.

Gjatë ballafaqimit për vënien e rendit dhe ligjit heroikisht ka rënë në krye të detyrës në mbrojtje të Kushtetutës, ligjit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës, Enver Zymberi.

Fatkeqësisht, dje në orët e pasdites, një grup i organizuar kriminal i udhëhequr nga liderët e strukturave paralele serbe dhe autoritetet e Beogradit, kanë sulmuar fillimisht pikën 1, e më pas në orët e mërkurës atë 31.

Pika 1 është djegur dhe dëmtuar në masë të madhe kontejnerët, ndërsa pika 31 është mbrojtur nga forcat e KFOR-it dhe ato të Policisë së Kosovës.

Më lejoni t'ju informoj se në pikën 31 janë zhvilluar ballafaqime të ashpra prej forcave të KFOR-it dhe Policisë së Kosovës, me bandat e armatosura serbe. Pika 31 është në kontroll të plotë të Policisë së Kosovës dhe autoriteteve të KFOR-it.

Mund të them se policët e Kosovës kanë qëndruar dhe po qëndrojnë heroikisht në pikat kufitare të Republikës së Kosovës.

Në pikën 1, nga ajo që kam theksuar dje qartë, lëshimet që kanë ndodhur edhe mos mbështetja e duhur, janë djegur disa kontejnerë, kontejnerët janë djegur, po ju them sot pika 1 është në kontrollin e autoriteteve të KFOR-it dhe ndërrimet edhe në pikën 31 për forcat e Policisë së Kosovës edhe pikën 1, do të rikthehen policët e Kosovës, është çështje orësh, nuk do të ketë rikthim prapa.

Vendimi për vënien e rendit dhe ligjit është në fuqi për reciprocitet me Serbinë, vendimi është në fuqi, nuk do të ketë zbrapsje.

Këto veprime të dhunshme të bandave kriminale janë urdhëruar, koordinuar dhe të udhëhequra nga strukturat me të larta politike të Beogradit.

Kontejnerët në pikën 1 janë djegur nga njerëzit me maska, por prapa kësaj djegieje qëndron politika antikosovare, antievropane, antiperëndimore, lakuriqe e Beogradit. Dhe, Prishtina e bën përgjegjës direkt politikën e Beogradit. Kjo është për të ardhur keq, kjo është politika e vjetër e Serbisë në raport me Kosovën. Kjo nuk është politika e fqinjësisë.

Ritheksoj, forcat e KFOR-it dhe Policia e Kosovës kanë mbajtur kontrollin në pikën 31, ndërsa pika 1 është rimarr nga forcat e KFOR-it dhe aktualisht është mbyllur për qarkullim. Çdo mjet që kalon aty, makina, të lëvizjes së lirë të njerëzve kontrollohet në detale, ndërsa trafiku komercial është i mbyllur. Pra, respektohet në përpikëri reciprociteti.

Qeveria e Kosovës është e vendosur të ndërmarrë veprime të menjëhershme qysh sot për të riparuar logjistikën e dëmtuar në pikën 1, me qëllim që aty të dërgohen përsëri menjëherë oficerët e Policisë Kufitare të Kosovës, së bashku me doganierët.

E kam theksuar dhe e ritheksoj se nuk do të bëjmë kompromis me askënd për sigurinë e vendit tonë. Nuk do të dialogojmë me askënd për rregullimin tonë të brendshëm. Rregullimi i brendshëm i shtetit të Kosovës është i përcaktuar qartë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e Kosovës, me dokumentin e presidentit Ahttisari.

Integriteti territorial i Kosovës është i paprekshëm dhe i njohur ndërkombëtarisht. Ne punojmë për hapjen e kufijve, por në asnjë rrethanë dhe me asnjë çmim nuk do të lejojmë ndryshimin e kufijve, që është aspiratë e politikës, që ishte aspiratë edhe e Millosheviqit dhe që është aspiratë e hapur edhe sot e politikës së liderëve të rinj të mentalitetit të vjetër të politikës së Beogradit.

Aktualisht, në këto momente që iu drejtohem juve deputetë të nderuar,
Kabinet qeveritar,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në pikën kufitare 31, Policia Kufitare e Kosovës, së bashku me doganierët, janë duke kryer punën e tyre, ndërsa KFORI është duke ofruar siguri të plotë.

Më lejoni në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në emër të gjitha institucioneve të Kosovës, të shpreh falënderimin për autoritetet e KFOR-it, për gjithë ushtarët e KFOR-it që sakrifikuan gjithçka patën dhe u ballafaquan në betejën për siguri edhe me rrezikim jete, por nuk lejuan banditët të marrin kontrollin.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të përsëris edhe një herë, se në asnjë rrethanë dhe me asnjë çmim nuk do të ketë asnjë hap mbrapa. Nuk do të ketë rikthim prapa në gjendjen e para 4 ditësh, nuk do të ketë rikthim prapa në gjendjen e statuskvos, nuk do të ketë rikthim në gjendjen e mëhershme. Qeveria e Republikës së Kosovës është e konsultuar dhe koordinuar me gjithë faktorët që punojnë për rend, ligj, respektim të Kushtetutës së Kosovës dhe ligjet e Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës në këtë vendim të drejtë është e përkrahur prej të gjithëve atyre që punojnë për rend, ligj, për demokratizim, për Kosovën e re demokratike dhe multietnike, për Kosovën e re evropiane.

Masat e reciprocitetit me Serbinë do të instalohen dhe zbatohen në gjitha pikat kufitare me Serbinë dhe kjo do të zgjasë derisa Serbia nuk ndryshon qëndrimin e saj.

Nuk do të ketë dialog për çështjet që kemi diskutuar dhe kemi marrë pëlqimin e Kuvendit, me Serbinë në terren, rregullimin e brendshëm e rregullojmë ne, ai është autoritet yni, ajo është e drejta jonë kushtetuese dhe ligjore.

Prishtina ka qenë e gatshme, është e gatshme edhe sot, për të vazhduar dialogun për çështjet praktike në të mirën e dy shteteve dhe popujve tanë, por në asnjë rrethanë të diskutojmë me asnjë vend dhe me askënd për rregullimin e brendshëm të Republikës së Kosovës.

Dua t'ju siguroj se skenari i Serbisë për ndarjen e veriut të Kosovës, nuk do të ndodhë kurrë dhe me asnjë çmim.

Institucionet e Republikës së Kosovës do të shfrytëzojnë gjithë autoritetin e tyre kushtetues dhe ligjor për të mbrojtur çdo pëllëmbë të territorit të Republikës dhe për t'u përballur me gjithë njerëzit e mosrespektimit të rendit dhe ligjit.

Vendimi për marrjen në kontroll të pikës 1 dhe 31, ka qenë vendim i drejtë, nuk ka qenë i orientuar kundër askujt, prandaj dëshiroj të theksoj se ky vendim ka qenë në shërbim të ruajtjes së qetësisë, sigurisë dhe tërësisë territoriale të Republikës së Kosovës, që është detyra jonë parësore. Për këto parime në asnjë rrethanë nuk do të ketë kompromis.

Të nderuar deputetë,
Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,

Realisht, jemi në një ballafaqim të ri, por kam besim të plotë si kurrë ndonjëherë më parë në këto 12 vjet se të bashkuar si qytetarë, të bashkuar si politikë në mbështetje të institucioneve të rendit dhe ligjit, të vendimeve të institucioneve të shtetit të pavarur dhe sovran, të vendimeve tona sovrane, ne do t'ia arrijmë qëllimit. Ky vendim dhe mision yni i tejkalon çdo ndarje politike apo etnike.

Është e qartë që turmat e dhunshme kriminale, të motivuara dhe financuara nga autoritetet e Beogradit, po synojnë që ta sfidojnë integritetin tonë dhe pushtojnë një pjesë të territorit të Kosovës.

Unë jam i bindur dhe i sigurt se diçka të tillë bashkërisht nuk do të tolerojmë. Ritheksoj edhe një herë, do të shfrytëzojmë gjithë autoritetin tonë kushtetues dhe ligjor në mënyrën më të vendosur të mundshme dhe me çdo çmim.

Kjo dëshirë e tyre e përjetshme e trashëguar nga politika gjenocidale e Millosheviqit, në asnjë rrethanë nuk do të ketë sukses, as nga politikanët e rinj të Beogradit.

Është e destinuar të dështojë, sepse në shekullin 21 përpjekjet për pushtim të territoreve përmes dhunës janë të papranueshme nga bota demokratike.

Me veprimet e fundit të dhunshme të Serbisë edhe një herë është demaskuar publikisht politika e Beogradit ndaj Kosovës.

Ritheksoj edhe një herë ne në asnjë rrethanë nuk do të **biem** në grackën e tyre. Ballafaqimi ynë është për vënien e rendit dhe ligjit.

Unë i falënderoj gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, ju falënderoj gjithë juve, gjithë spektrin politik për mesazhe të urta, të matura, për ruajtjen e qetësisë, për mirëkuptimin dhe besimin tek institucionet e shtetit të Kosovës.

Kjo situatë e re dhe ky ballafaqim i ri është edhe mesazh se relacionet ndëretnike në Kosovë janë duke u përmirësuar.

Unë falënderoj gjithë qytetarët për gjakftohtësinë e tyre, për maturinë e tyre, për mirëkuptimin dhe solidaritetin që kanë treguar. Ballafaqimi ynë është për vënien e rendit, ligji, Kushtetutës në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Këto turma të dhunshme kriminale serbe nuk janë qytetarët serbë shtetas të Republikës së Kosovës, ata janë faqja e zezë e komunitetit serb në Kosovë. Ata janë e keqja e komunitetit serb në Kosovë, ata janë duke turpëruar komunitetin serb në Kosovë. Komuniteti serb në Kosovë, gjithnjë e më tepër po distancohet nga ata. Kanë mbetur individë në Kosovë që e përqafojnë politikën e dhunës së Beogradit në Kosovë, e në ditët e ardhshme do të mbesin gjithnjë e më tepër edhe më pak, sepse politika e urtë e mirëkuptimit dhe bashkëjetesës, do të ngadhënjejë mbi atë të dhunës dhe mbi politikën kriminale.

Ne kemi të ardhme të përbashkët për Kosovën si atdhe i gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, në një bashkëjetesë, mirëkuptim dhe rritje të mirëqenies sociale të qytetarëve. Ne do të vazhdojmë ballafaqimin tonë për vënien e rendit dhe ligjit dhe do të kemi sukses, por do të vazhdojmë edhe për investime socio-ekonomike në gjithë territorin e Republikës së Kosovës edhe në veri. Serbët në veri dhe gjithë qytetarët që jetojnë atje kanë nevojë për jetë më të mirë dhe jo për dhunë çfarë manipulohen tani nga disa ekstremistë. Ata do të dështojnë përballë institucioneve legjitime të Kosovës, përballë rendit dhe ligjit dhe misionit ndërkombëtar që janë të instaluar në Kosovë, në veçanti KFOR-it.

Ata që mendojnë se do t'i sfidojnë institucione legjitime dhe legale të Republikës së Kosovës, gabohen rënd, ata që mendojnë që do ta sfidojnë KFOR-in, gabojnë rënd. Ai është thjeshtë, ai pretendim për sfidim të institucioneve të Kosovës dhe KFOR-it, është mendim i së kaluarës, është mendim i mbeturinave të Slllobodan Millosheviqit.

Prandaj, edhe një herë më lejoni që t'i ftoj qytetarët për mirëkuptim dhe qetësi, të kenë besim tek institucionet e shtetit të Kosovës, të kenë besim tek institucionet e Kosovës, të kenë besim në KFOR-in, pra në NATO-n.

Ju garantoj se do ta kthejmë rendin dhe ligjin në veri me çdo çmim, por kërkojmë solidaritet, unitet, mirëkuptim dhe besim tek institucionet e vendit. Tani kemi institucione legjitime të zgjedhura që kanë marrë përgjegjësinë për zbatimin e plotë të Kushtetutës dhe ligjeve.

Vetëm edhe një incident ndëretnik, gjithë këtë vendim, gjithë këtë ballafaqim e dëmton te institucioneve të Kosovës. Misioni ynë është në shërbim të gjithë qytetarëve, nuk është për një etni kundër një etnie, nuk janë palët në konflikt. Në konflikt është beteja apo ballafaqimi për rend dhe ligj me banditët dhe kriminelët e dhunshëm, me kontrabanduesit dhe paramilitarët, është ballafaqim i të mirës me të keqen, i të sotmes dhe së ardhmes, me të kaluarën.

Prandaj, ne nuk do të zmbrespsemi, ne do të vejmë rendin dhe ligjin dhe për Kosovën do të ketë vetëm ecje përpara dhe integrim në NATO dhe Bashkim Evropian, me integritetin territorial të njohur dhe të garantuar edhe ndërkombëtarisht. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!
Adem Grabovci e ka kërkuar fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër, Kabinet qeverisës,
Kolegë të nderuar,

Të gjithë jemi të shqetësuar dhe kemi përcjellë me vëmendje dhe seriozitetin më të madh rrjedhën e ngjarjeve në veri të vendit. Gjatë këtyre ditëve kemi pasur biseda dhe konsulta të përbashkëta mbi rrjedhat në veri të vendit. Deputetët e të gjitha grupeve parlamentare të Kosovës jemi dakorduar që është e domosdoshme që sot të mbahet një seancë e jashtëzakonshme ku do të diskutohet, do të debatohet dhe do të nxirret një rezolutë në përkrahje të vendimeve dhe veprimeve të Qeverisë së Kosovës, për vënien e rendit dhe ligjit në tërë territorin e Kosovës, kërkesë kjo që ka qenë nga ne, nga gjithë qytetarët që 12 vjet me radhë. Vlerësojmë se vendimi i Qeverisë së Kosovës ka qenë në përputhje të plotë me Kushtetutën e vendit dhe marr të drejtën që t'i falënderoj të gjithë deputetët e Kuvendit, të gjitha grupeve parlamentare që kemi qenë të njëzëshëm, të një mendimi në këtë pikë.

Prandaj, i propozoj kësaj seance që sot të bëjmë një shmangie nga pikat e rendit të ditës dhe në pikën një dhe dy të hiqen nga rendi i ditës, Deklarimet jashtë rendit të ditës dhe Pyetjet parlamentare dhe në pikën e parë të kemi një debat mbi gjendjen në veri të vendit dhe nxjerrjen e një rezolute të përbashkët nga të gjitha grupet parlamentare, që edhe një herë po theksoj rikonfirmojnë mbështetjen e Qeverisë së vendit që i jep institucioni më i lartë i vendit legjislativ, Kuvendi i Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ne pra kemi një mocion, rendi është që ta kërkojmë mendimet e grupeve parlamentare ose të shefave. Do të thotë, kërkesa erdhi nga shefi ose kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, po në emër të deputetëve të të gjitha grupeve parlamentare. Unë kërkoj mendimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zotit Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ajo që zoti Grabovci e propozoi, realisht, nuk është seancë e jashtëzakonshme, por është një mocion, siç e thatë ju, dhe nuk ka asnjë arsye që Lidhja Demokratike e Kosovës, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës të mos e përkrah. Do të thotë, ne e përkrahim që të jetë ky mocion, të votohet dhe këto dy pika, siç u tha, të shndërrohen në debat për gjendjen në veri të Kosovës, pa dashur ta zgjas, sepse nëse ky miratohet, sigurisht ne do ta themi pastaj qëndrimin tonë si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të “Vetëvendosjes”, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Lëvizja “Vetëvendosje” mendon që sot duhet të debatohet vetëm për gjendjen në pjesën veriore të vendit. Nuk bën Kuvendi që sot të aktrojë thua ti situata është jashtëzakonisht normale në Kosovë, për shkak se të gjithë e dimë që nuk është jashtëzakonisht normale. Prej dje kur kemi diskutuar me shefat e grupeve parlamentare që ka qenë gjatë ditës për ta bërë sot një seancë të jashtëzakonshme, shumë gjëra kanë ndodhur dhe shumë ka ndryshuar në situatën në terren. Pra, ne të gjithë e dimë që njëra prej pikave doganore të Kosovës, me Serbinë, një pikë kufitare është djegur përsëri nga strukturat paralele të Serbisë dhe pajtohem me kryeministrin Thaçi që thotë të dirigjuara nga Beogradi, por kjo është një mundësi ose shumë lehtë mund të kuptohet si një lloj agresioni nga Serbia dhe si e tillë është e pakuptimtë që Kuvendi të vazhdojë edhe të debatojë për Ligjin për duhanin apo Ligjin për verërat apo ligjet tjera që do t’i debatojmë këtu.

Ne jemi të vetëdijshëm se jemi vonë me ligje dhe konsiderojmë që është detyrë e Kuvendit që këto ligje t’i miratojë sa më shpejtë që është e mundur, në mënyrë që tërësia legjislative e Kosovës të përmbyllet.

Mirëpo Lëvizja “Vetëvendosje” konsideron që Kuvendi duhet të punojë më shumë në këto rrethana dhe jemi të gatshëm të punojmë edhe nesër, edhe pasnesër edhe të hënën e të martën, në javët në vazhdim. Mirëpo, sot duhet që të jemi karshi situatës e situata nuk është e zakonshme në Kosovë, po e përsëris, prandaj, konsiderojmë që duhet të debatojmë vetëm për veriun dhe atë jo vetëm dy orë por sado që të ka nevojë dhe ta përfundojmë këtë siç e tha edhe shefi i Grupit Parlamentar, me një rezolutë të përbashkët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj se është në rregull që Kuvendi të debatojë për situatën në veri të Kosovës dhe për vendosjen e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë atje. Pajtohem që ta nxjerrim një deklaratë ose një rezolutë cilado që të jetë ajo. Mendoj se fuqia e Kuvendit mund të tregohet edhe me kufizim të numrit të fjalëve, nuk kem nevojë të flasim të gjithë. Mund ta harmonizojmë një deklaratë ose rezolutë ose çka do që të merremi vesh dhe të shkojmë më tutje. Do të thotë, në parim edhe ne e mbështesim idenë që Kuvendi të dalë me një qëndrim të vetin në lidhje me situatën e krijuar së fundi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet për Kabinetin qeveritar dhe gjithë deputetët e pranishëm në seancë!

Duke marrë parasysh se dje të gjithë shefat e grupeve parlamentare kemi rënë në dakord që sot të kemi këtë mocion në seancë dhe duke marrë parasysh gjendjen momentale në

pjesën veriore të Kosovës, atëherë edhe Koalicioni për Kosovë të Re është në pajtim që të diskutohet ky mocion dhe të miratohet një rezolutë e përbashkët e Kuvendit të Kosovës nga të gjitha grupet parlamentare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit të SLS-së, nuk ka.

Në emër të Grupit “6+”, kush e do fjalën?

Fjalën e ka deputeti Enis Kervan.

ENIS KËRVAN: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah propozimin dhe mendojmë që sot duhet të debatojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tash i kemi dy mocione, kemi mocionin e deputetit Adem Grabovci dhe një ndryshim është në kërkesën e Grupit për “Vetëvendosje”. Ne po shkojmë sipas kërkesës së deputetit dhe kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Adem Grabovcit. Por, mund të shkojmë edhe ta bëjmë si seancë të veçantë këtë pjesën e parë dhe pastaj të fillojmë me seancë tjetër. Është mirë ta qartësojmë këtë para se ta qesim në votim njërën apo tjetrën. Mund ta bëjmë një seancë sipas kërkesës së deputetit Adem Grabovci, e pastaj pas një pauze, fillojmë seancën tjetër. A jeni dakord kështu të shkojmë? Ta kemi një seancë po e quajmë nëse doni - emergjente, ose nëse doni - të jashtëzakonshme, pasi të mbyllet debati për këtë vazhdojmë seancën e punës. A jeni dakord?

Ne debatin s’po e kufizojmë, po e bëjmë një seancë për gjendjen në veri të Kosovës dhe pastaj vazhdojmë, pasi të kryhet kjo seancë, vazhdojmë me seancën tjetër. A jeni dakord për këtë formë?

Kush është për këtë? Faleminderit! A ka “kundër” ? Një.

Pra seanca vendosi që fillimisht të jetë një seancë për gjendjen në pjesën veriore të Kosovës dhe pas kësaj fillojmë me seancën e rregullt, pas përfundimit të saj.

Urdhëro, Sabri!

SABRI HAMITI: Zoti kryetar,

Zoti kryeministër,

Zotërinj zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritar,

Deputetë të respektuar,

Meqë tash u mor vendimi që për këtë temë do të diskutohet sot, atëherë zoti kryetar, sepse s’kishte nevojë edhe të quhet e jashtëzakonshme, se mund të bëhet diskutimi urgjent me rregulloren tonë në çdo moment dhe unë e konsideroj situatë urgjente, sido që të jetë, u vendos. Unë propozoj që, meqë po fillojmë të bisedojmë për këtë temë, të jepen 10 minuta pushim, në mënyrë që të bëhen konsultimet elementare, po them, sepse përfundimtare bëhen mbas bisedimeve për të prodhuar, qoftë një dokument, 10 minuta pushim për konsultime.

KRYETARI: Mirë, faleminderit!

Atëherë, ne veç votuam, Kuvendi për mënyrën e vazhdimet të punës. Edhe unë jam që pasi kjo hyri në rend të ditës, 15 minuta, apo pas 15 minutave fillon seanca. 15 minuta pauzë!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hapi punimet e Seancës së jashtëzakonshme me këtë pikë të rendit të ditës:

Gjendja e aktuale në pjesën veriore të Republikës së Kosovës

Në mbledhje janë të pranishëm 87 deputetë, që do të thotë mund të fillojmë me punë. Fillimisht, ftoj Kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçi që ta marrë fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, i nderuari kryetar Krasniqi!

Të nderuar deputetë,

Fillimisht, ritheksoj se Qeveria e Republikës së Kosovës do të jetë dhe unë personalisht do të jem aktiv në këtë debat për gjendjen në veri. Do të jemi pjesë aktive e këtij debati dhe të përgjigjem në çështje që ju mund të ngrisni.

Gjithashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës, çdo rezolutë, rezolutën të cilën do ta nxirrni ju, si Kuvend, do ta respektoj në përpikëri. Në anën tjetër, dëshiroj t'ju informoj edhe zyrtarisht, siç jeni të informuar prej medimeve, se sot do të mbahet mbledhja e Këshillit të Sigurimit në Nju Jork. Ministri i Jashtëm, zoti Enver Hoxha, është rrugës për në Nju Jork dhe do ta prezantojë qëndrimin e shtetit të Kosovës për situatën e re, situatë në të cilën Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i respektojë në përpikëri obligimet kushtetuese dhe ligjore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ftoj zotin Adem Grabovci, që para deputetëve të paraqesë arsyetimin për pikën e propozuar për këtë rend dite.

ADEM GRABOVCI: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Unë kam përgatitur një Projekt-rezolutë që do t'ua propozoj, me të drejtën që bashkërisht të korrigjojmë, të plotësojmë dhe të dalë Rezolutë e Kuvendit të Kosovës.

Duke u nisur nga neni 65.1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nga neni 6.1 i Rregullores së Kuvendit,

Duke nisur nga e drejta e institucioneve për ushtrimin e kontrollit efektiv në tërë territorin e Republikën e Kosovës,

Duke u nisur nga parimet bazë të dokumenteve ndërkombëtare për Kosovën,

Duke u nisur nga e drejta e shteteve sovrane për kontroll të kufijve të vet, Kuvendi i Republikës së Kosovës, nxjerr këtë:

REZOLUTË

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës fuqizon të drejtën kushtetuese të institucioneve për ushtrimin e kontrollit të plotë në tërë territorin e vendit.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet Qeverinë në vendosjen e rendit dhe të ligjit në tërë territorin e Republikës.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria që me mjetet e saj ligjore dhe kushtetuese të ruaj tërësinë territoriale të vendit tonë.
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon që të respektohen masat e reciprocitetit me Serbinë në të gjitha pikat doganore.
5. Kuvendi i Republikës së Kosovës fton bashkësinë ndërkombëtare për të përkrahur institucionet e vendit në vendosjen e rendit dhe të ligjit në gjithë territorin e Republikës.
6. Kuvendi i Republikës së Kosovës fton të gjithë qytetarët e Kosovës që të respektojnë vendimet e institucioneve të Kosovës për ndërtimin e rendit dhe sundimin e ligjit në vendin tonë demokratik, dhe
7. Kuvendi i Republikës së Kosovës u bën thirrje të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa asnjë dallim, që ta ruajnë qetësinë dhe rendin kushtetues në vendin tonë.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Tani është radha e grupeve parlamentare. Konsideroj se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e tha fjalën e vet.

Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

ISMET BEQIRI: I nderuar zoti kryetar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka ndjekur me shqetësim të thellë ngjarjet në veri të vendit, pjesë në të cilën është rrezikuar rëndë gjendja e sigurtisë.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i vlerëson si kriminale dhe të papranueshme të gjitha veprimet e bandave serbe, veprime këto të nxitura nga

institucionet e Serbisë dhe strukturat ilegale serbe në veri. Grupi Parlamentar i LDK-së dënon ashpër sulmin ndaj pikave kufitare në veri dhe djegien e tyre nga bandat serbe.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës u bën thirrje strukturave ndërkombëtare të sigurisë të pranishme në Kosovë që të përmbushin mandatet e tyre në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ne inkurajojmë institucionet tona vendore në angazhimin e tyre që t'i koordinojnë dhe të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje nga prezenca ndërkombëtare e sigurisë në shtetin tonë, veçmas nga KFOR-i, si garant i fuqishëm i sigurisë në Republikën e Kosovës.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, sikurse edhe LDK-ja, në prononcimet e saja të mëhershme, edhe një herë shpreh mbështetjen e saj për vendosjen e rendit dhe të ligjit, për sundimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, për luftimin e krimit, të korrupsionit dhe të kontrabandës.

Po ashtu, ne shprehim ngushëllimet e thella familjes së Enver Zymberit, Heroit më të ri të Kosovës, dhe po ashtu Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës u bën thirrje qytetarëve të Kosovës që të ruajnë qetësinë në këto momente nëpër të cilat po kalon shteti ynë. Sigurisht që, si Grup parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, pas prezantimit të draft-rezolutës, ne në fund, siç e do rendi, do ta shikojmë do të thotë bashkërisht dhe jemi në favor të një rezolute, e cila padyshim fuqizon punën dhe angazhimin e institucioneve tona në drejtim të qetësimit, të stabilizimit dhe të shtrirjes së sovranitetit tonë në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, fjalën e ka deputeti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Me 24 mars të vitit 2008, Lëvizja “Vetëvendosje” ia drejtoj një letër Qeverisë së Kosovës me 10 kërkesa dhe rekomandime. Njëra prej më të rëndësishmëve, ishte dërgimi i Policisë të Kosovës dhe i njësiteve speciale të saj në pjesën veriore të Kosovës, si dhe vënia nën kontroll e këtij territorit të Kosovës, së bashku me shtrirjen e sovranitetit, të ligjit dhe të rendit në të gjithë Republikën tonë.

Që prej asaj kohe, sa here ia kemi përmendur Qeverisë obligimet e saj për integritetin territorial të vendit, ajo bashkë me analistët e saj rregullisht na ka akuzuar pa kurrfarë arsye për dhunë, gjakderdhje e gjëra të tilla, ku në fakt kemi të bëjmë me obligime shtetërore, kombëtare e ligjore.

Është mirë që më në fund Qeveria e la me një anë propagandën dhe i kuptoi detyrat e veta kushtetuese dhe shtetërore në funksion të sovranitetit të Kosovës. Natën e 25 korrikut, me vendim të Qeverisë sonë, u mobilizuan njësitet speciale dhe pjesëtarë të Policisë së Kosovës për ta vendosur kontrollin e shtetit të Kosovës mbi pikat doganore 1

dhe 31, të djegura nga strukturat e paligjshme të Serbisë dy ditë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Policët e Kosovës kanë vuajtur për vite të tëra në pritje të këtij vendimi të vonuar qeveritar. Gatishmëria e tyre për mbrojtjen e sovranitetit tonë republikan, ka qenë e pashembullt. Njëri prej tyre, Heroi Enver Zymberi, nga Dubovci i Vushtrisë, ra në krye të detyrës në mbrojtje të kufijve tanë shtetërorë. Por, ajo çka u kuptua pas aksionit të Qeverisë, ishte fatkeqësisht se më shumë kemi të bëjmë me një polici të gatshme për Qeverinë, por me një Qeveri të pa gatshme për policinë. Logjika e shëndosh thotë: “Më mirë herët se vonë”, dhe ky ka qenë viti 1999, por bashkimi i Kosovës nuk ndodhi. Populli thotë: “Më mirë vonë se kurrë”, ky ka qenë 17 shkurti i vitit 2008, por bashkimi i Kosovës sërish nuk ndodhi. Por, mbi të gjitha, më mirë hiq se keq, dhe kjo ka qenë ndërhyrja e fundit e Qeverisë në veri dhe ne tash ne këtu po merremi me pasojat.

Prandaj, ndonëse e inkurajojmë vullnetin qeveritar për marrjen e asaj që na takon, pra të pikave 1 dhe 31, tash pasi kaluan pak ditë nga ndërhyrja në pjesën veriore, është koha po ashtu që të reflektojmë edhe për mangësitë dhe gabimet. Kjo nuk është në asnjë mënyrë thirrje për të mos vepruar, por kjo është thirrje për veprim më të planifikuar.

Së pari, kryeministri Thaçi e trajtoi këtë çështje po sikur pavarësinë e Kosovës, pra më shumë për imazh, se sa për sovranitet dhe më shumë si protagonizëm personal, se sa si sukses institucional dhe kolektiv. Dhe, ashtu sikurse që ndodhë me çdo ndërmarrje individuale, e cila është e pamjaftueshme për të korrur sukses të përgjithshëm, e tillë ishte edhe kjo e kryeministrit tonë.

Hashim Thaçi deshi t’i bënte të gjitha vet. Ai ishte planifikuesi, urdhërdhënësi, zbatuesi dhe mbikëqyrësi i një operacioni top sekret. Prandaj, rezultatet janë këto që janë. Të hënën u dërguan njësitë speciale të policisë në pikat doganore dhe kjo ishte një gjë e mirë, të cilën e përshëndetëm. Të martën, njësitet speciale u tërhoqën nga pjesa veriore, kurse ata pak policë që mbetën, qëndruan atje të izoluar për shkak të ndërprerjes së linjave të komunikimit fizik nga barrikadat e shpeshta të strukturave të Serbisë dhe, të mërkurën, strukturat kriminale të Serbisë i sulmuan dhe dogjën pikat doganore dhe këto struktura u panë të udhëhiqeshin po ashtu edhe nga Borisllav Stefanoviqi, kryenegociatori serb, të cilin Qeveria e priti në selinë e saj, kurse Edita Tahiri e pati quajtur - njeri me ide të shkëlqyera!

Tash Qeveria po i vuan pasojat e mos veprimeve të veta, të cilat kanë krijuar një problem kumulativ. Përgjatë 12 vjetërve janë toleruar strukturat e paligjshme të Serbisë dhe tash gjendemi në situatën kur ato të armatosura i bëjnë pusi Policisë sonë gjatë ushtrimit të detyrave kushtetuese.

Ne inkurajojmë Qeverinë e Kosovës që ta rikthejë kontrollin e shtetit në pikat doganore. Po ashtu, themi se Qeveria boll ka vajtuar për veprimet e bandave kriminale serbe. Tash është koha për veprim kundër strukturave të paligjshme të Serbisë.

Aq ishte i etur kryeministri ynë për sukses personal, sa që e harroi pak edhe koordinimin e tij të zakonshëm me miqtë ndërkombëtarë dhe tash, në vend që të ishim duke e konsoliduar praninë tonë shtetërore në atë pjesë të Kosovës, përgjatë këtyre katër ditëve pamë dobësim të pozicioneve, mpakje të vullnetit, tërheqje dhe njëfarë zmbarsjeje.

Lëvizja “Vetëvendosje” dëshiron të beson fuqimisht se, me gjithë defektet, kjo ishte një ndërhyrje vullnetmirë për forcimin e sovranitetit të shtetit të Kosovës dhe nuk dëshirojmë të besojmë aspak, ndonëse na frikëson shumë mundësia që ky akt të rezultojë vetëm me provokim, lënien në gjysmë, tërheqje dhe përfundim të çështjes së veriut në negociata. Urojmë që kjo të mos ndodhë! Kjo e fundit do të ishte vetëvrasje përfundimtare për Qeverinë, por edhe për interesin shtetëror të Republikës së Kosovës.

Lëvizja “Vetëvendosje”, për shkak të situatës së rëndë në veri të Kosovës, propozon pikat në vijim, të cilat duhet t’i ketë parasysh Qeveria e Kosovës, por edhe institucionet tjera:

Së pari, në bazë të nenit 131 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, Presidentja e vendit duhet të shpallë gjendje të jashtëzakonshme në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Në përputhshmëri me këtë nen, Kosova ka nevojë për masa emergjente të mbrojtjes, sipas nenit 131, paragrafi 1, pika 1, si dhe ka rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues dhe sigurisë publike sipas nenit 131, paragrafi 1, pika 2. Në ditët e kaluara, institucionet e Kosovës janë sulmuar me armë të ndryshme nga strukturat paralele, të financuara nga shteti i Serbisë, si dhe është cenuar rënd sovraniteti i shtetit të Kosovës, duke u sulmuar drejtpërdrejt pikat kufitare të shtetit tonë.

Kërkesa e dytë është që të ndërpritet menjëherë dhe zyrtarisht procesi i bisedimeve me Republikën e Serbisë dhe të iniciohet sa më shpejt aktivizimi i resurseve qytetare dhe institucionale për mbrojtjen e Kosovës.

Kërkesa e tretë është që në ditët në vijim, Kosova duhet ta ketë situatën emergjente dhe ta thellojë bashkëpunimin me Republikën e Shqipërisë, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me shtetet e BE-së që na kanë njohur, si dhe me Turqinë për strategjinë e ushtrimit të autoritetit të Republikës së Kosovës në të gjithë shtetin tonë.

Pika e radhës është që Republika e Kosovës menjëherë duhet t’i fillojë diskutimet me Brukselin për përfundimin e misionit të EULEX-it në Kosovë dhe për ta ridefinuar këtë prani të ndërkombëtare në Kosovë, nga misioni me fuqi ekzekutive dhe me imunitet ndaj ligjit, në misione mbështetëse për zhvillim të qëndrueshëm, demokraci dhe drejtësi.

Siç e kemi thënë rregullisht në tri vitet e fundit, EULEX-i është një mision i padrejtë, jodemokratik, neutral ndaj statusit të Kosovës, pra që nuk e njeh pavarësinë tonë dhe që nuk e forcon shtetin e Kosovës dhe ngjarjet që ndodhën tash në veri, e konfirmuan këtë gjë.

Dhe, kërkesa e fundit është që në seancat e vazhdueshme të Kuvendit të Kosovës, Qeveria ta diskutojë së bashku me ne të gjithë, strategjinë e marrjes së kontrollit në veri të vendit. Lëvizja “Vetëvendosje” edhe një herë thotë që vetëm bashkimi, organizimi dhe mobilizimi i përgjithshëm i qytetarëve, të institucioneve dhe të subjekteve politike e shoqërore për ta mbrojtur Kosovën dhe për ta mbështetur Policinë dhe institucionet e tjera që ta mbrojnë Kosovën, është rruga duhur përpara drejt zgjidhjes.

Për shkak se ne konsiderojmë që situata aktuale kërkon që të gjitha institucionet shtetërore të jenë në krye të përgjegjësisë, ne këmbëngulim që seanca e sotme, edhe një herë në përgjithësi t’i kushtohet zhvillimeve të fundit dhe gjendjes në veri. Nuk mund t’ia lejojmë vetes si deputetë që të aktrojnë normalitetin me ligje mbi verërat, e mbi duhanin në kohën kur Republikës sonë po i digjen kufijtë.

Por, nëse vazhdohet me këtë aktrim, atëherë ne po paralajmërojmë që Lëvizja “Vetëvendosje” nuk mund të jetë pjesë e kësaj maskarade.

KRYEETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën!

AHMET ISUFI: Të nderuar deputetë të Parlamentit të Republikës së Kosovës,
Kabinet qeveritar,

I nderuar kryetar i Parlamentit,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka vlerësimin e vet për ngjarjet e fundit në territorin e veriut të Kosovës dhe tri vite pas pavarësisë së Kosovës, kemi një interesim për të pasur rend dhe ligj dhe zbatim të Kushtetutës në veriun e Kosovës.

Veprim i tillë u harmonizua dhe po ashtu u përkrah nga institucionet e Kosovës, nga qytetarët dhe nga të gjithë ata që donë prosperitetin e Kosovës, zbatimin e Kushtetutës dhe vënien e rendit dhe të ligjit në një pjesë të territorit të Kosovës. Ky entuziazëm, normalisht që ishte shenjë e mirë për qytetarët dhe për vendin, por dërgimi i njëjve speciale në veriun e Kosovës dhe tërheqja e menjëhershme e tyre, rezultoi me të dhënat që i kemi tani. Kemi rënien e Heroit të Kosovës, Enver Zymberi, me të cilin rast edhe një herë i shprehim ngushëllime familjes, kolegëve dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës, kemi djegien e pikës 1 dhe tendencën për djegien e pikës 31 doganore të Kosovës, kemi plagosjen e disa policëve atje dhe kemi prezencën e instrumenteve institucionale të Serbisë në veriun e Kosovës.

Kjo Qeveri edhe më tutje flet për dialogun, ndërsa në veriun e Kosovës nxitet dhuna pikërisht nga Borko Stefanoviq, ai me të cilin ka dialoguar dhe pretendon të dialogojë kjo Qeveri. E keni parë i gjithë opinionin, bashkë me ministrin Bogdanoviq!

Kjo sjellje në këtë mënyrë ka ndikuar që të kemi këtë gjendje të tanishme në veriun e Republikës së Kosovës. Konsiderojmë se duke pasur parasysh se kryeministri thotë që e kemi planin për të pasur rend dhe ligj në veriun e Kosovës, për të pasur jetë të lirë të qytetarëve atje, për të pasur sovranitet, ky plan duhet të përfundohet deri në detaje, sepse

Kosova duhet të qeveriset, të administrohet dhe të jetë nën sistemin institucional të Republikës së Kosovës.

Më tutje, nuk duhet lejuar që të kemi viktimë, të kemi dhunë, të kemi gjendje çfarë është momentalisht. Kërkojmë nga Qeveria e Kosovës, që bashkë me instancat ndërkombëtare, në këtë rast, sidomos me KFOR-in që ka mision edhe për mbrojtjen edhe të kufirit, edhe të mbajtjes së rendit dhe të ligjit, që në veriun e Kosovës të ketë liri të lëvizjes, të ketë veprim institucional dhe të ketë funksionim normal të jetës së lirë të qytetarëve. Jo vetëm pikat doganore, jo vetëm policia, jo vetëm njësitë speciale, por komplet institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës duhet të kenë programet e tyre për veriun e Kosovës, në mënyrë që Kosova të administrohet dhe të qeveriset si vend sovran.

Dhe, në fund, kërkojmë nga kryetarët e grupeve parlamentare ta harmonizojnë Rezolutën dhe të na e sjellin këtu për ta votuar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, fjalën e ka deputetja Myzeje Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kryeministrin, zëvendëskryeministrat, ministrat dhe të gjithë deputetët e kësaj seance!

Duke marrë parasysh gjendjen në të cilën ndodhet shteti i Kosovës, Grupi parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re përkrah në parim Rezolutën e cila erdhi nga Grupi Parlamentar i PDK-së, me të gjitha plotësimet të cilat do të dalin nga të gjithë shefat e grupeve parlamentare dhe njëkohësisht veprimin e domosdoshëm për vendosjen e rendit dhe të ligjit në pjesën veriore të Kosovës, në mbështetje të veprimeve të Qeverisë së Kosovës, të angazhimit maksimal të autoriteteve për mbajtjen e qetësisë, demonstrimin e qartë të vendosmërisë për mostolerim të veprimeve kriminale të bandave serbe, demonstrimin e qartë politikës së Beogradit se Kosova nuk do të lejojë asnjë ndërhyrje të saj në çështjet e brendshme të Kosovës, respektimin e plotë të masave të reciprocitetit me Serbinë në të gjitha pikat doganore dhe kërkojmë nga Qeveria angazhim për bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me BE-në, me NATO-n për vendosjen e rendit dhe të ligjit dhe të kushtetutshmërisë në pjesën veriore të Kosovës.

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re shpreh edhe njëherë ngushëllimet më të përzemërta të familjes Zymberi, me rastin e humbjes së birit të tyre dhe njëkohësisht të gjithë qytetarëve të Kosovës që të ketë një qetësi, një vendosmëri dhe një politikë për shtetin e ri të Kosovës, të vendosjes së sovranitetit në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, nuk është lajmëruar. Në emër të Grupit “6+”, deputeti Rasim Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Poštovani predsedniče Skupštine,
Poštovani premijeru,
Parlamentarna grupa „6+“ vrlo pažljivo prati događaje na severu Republike Kosova i osuđujemo svaki vid nasilja. Dajemo punu podršku Vladi i institucijama Republike Kosova da istraju u očuvanju suvereniteta i teritorijalnog integriteta Republike Kosova.

Pozivamo predstavnike međunarodne zajednice da se maksimalno angažuju u očuvanju mira i reda u Republici Kosovo i još jednom izražavamo saučešće porodici Zumberaj!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Do të thotë, kemi përfundimin në emër të grupeve parlamentare. Fjalën ia kisha dhënë deputetit Nait Hasani.

NAIT HASANI: Ju faleminderit, kryetar!
Përshëndetje Kryeministrit, Kabinetit!
Ne, një seancë më herët që e kemi mbajtur për siguri në Mitrovicë dhe në veri, kemi pas deklaruar dhe kemi marrë rekomandime që Qeverisë t'i drejtohem që të marrë vendime dhe veprime.

Për herë të parë pas 12 vjetëve, po e shoh që në Kosovë Qeveria ekziston. Deri më tash kemi pasur planifikime, planifikime për drejtësinë, për pikat doganore, për rendin, për sundimin e ligjit, për të gjitha, por asnjëherë nuk kemi mundur ta vendosim. Unë nuk di ku ka qenë çështja, por çështja shihet se nuk kemi pasur guxim apo i kemi respektuar shumë miqtë tanë të cilët me përkëdheljet e tyre, duke dashur të na përqafojnë, na kanë kafshuar.

Para nesh e kam edhe një deklaratë që e pati dhënë atëherë ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi në atë seancë, kur thotë që grupet ekstreme serbe po mbajnë nën tension situatën e përgjithshme, duke shkaktuar incidente të ndryshme. Reagimi i Qeverisë me njësitë speciale për vendosjen e rendit dhe sundimit të ligji tregon se këto banda kriminale, këto struktura paralele të shtetit të Serbisë ekzistojnë dhe kanë ekzistuar atje.

Rënia e policit Enver Zymberi tregon se sa larg kanë shkuar këto struktura në veri dhe çfarë forcash dhe çfarë mjetesh demokratike duhet përdorur atje. Mendoj se çdo shtet ka të drejtë të përdorë institucionet e veta për sundimin e ligjit në gjithë territorin e vet. Ne e kemi një Kushtetutë dhe Kushtetuta na obligon të gjithëve, edhe neve si deputetë, edhe kryeministrin, edhe Kabinetin dhe të gjitha institucionet që të marrin vendime dhe të vendosim atje rendin dhe ligjin.

Vendimi i Qeverisë që është marrë, është mjaft i vonuar, por është i qëlluar. Unë mendoj që ky vendim që ka shkuar dhe është vendosur në pikat 1 dhe 31, nuk është i mjaftueshëm. Ne, nëse duhet ta kemi një stabilitet në Kosovë, po edhe në veri, nëse duhet të kemi sundim të ligjit, duhet t'i marrim të gjitha masat në përputhshmëri me ligjin.

Nëse kemi forca të përballemi me protestuesit tanë nëpër Prishtinë, pse nuk kemi forca të përballemi me ata protestues atje që e cenojnë të drejtën, ligjin dhe kushtetutshmërinë e Kosovës. Ky vendim, unë besoj se nuk do të zmbrapset, por nëse do të zmbrapset ky vendim, a do të heqim dorë nga, siç sugjerohet nga disa miq, atëherë ne kemi bërë një kundër efekt, i cili do të na kushtojë përjetë dhe për të cilin do të na gjykojnë brezat e ardhshëm. Unë mendoj se nuk do të ketë kthim prapa, por duhet të shkohet para, pra duhet të shkohet deri në fund. Duhet t'i tregohet edhe bashkësisë ndërkombëtare, duhet t'i tregohet edhe Serbisë se ne kemi mundësi, kemi forca të mjaftueshme dhe kemi vullnetin e popullit që ta vendosim rendin, sundimin e ligjit edhe në veri.

Rezoluta që është propozuar, besoj që është vetëm edhe një ndihmesë shtesë që do t'i jepet Qeverisë për ta vendosur rendin dhe ligjin. Prandaj, kërkoj nga Qeveria që t'i shqyrtojë raportet dhe marrëdhëniet me EULEX-in, pikërisht në aspektin kur ata kanë tentuar dhe tentojnë t'i mbrojnë strukturat kriminale atje. Nëse EULEX me misionin e vet në Kosovë ka ardhur për sundimin e ligjit, për të kundërtën kanë vepruar atje dhe vepron edhe sot dhe i bën pengesa Qeverisë në vendosjen e rendit dhe ligjit atje, do të thotë që ne duhet ta shqyrtojmë edhe raportin e Kosovës me EULEX-in. Prandaj, kërkoj edhe një herë me këmbëngulje, me forcë, me çdo mjet demokratik të vendoset rendi, sundimi i ligjit në veri të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Zoti kryetar,
Zoti kryeministër,
Kolegë të nderuar,

Ne sot këtu, po flas për LDK-në, nuk kemi ardhur as ta lavdërojmë Hashim Thaçin, as ta përmbysim Hashim Thaçin, por kemi ardhur të bisedojmë për Kosovën në një moment tepër të rëndësishëm dhe ajo që do të artikulojmë këtu, ka këtë qëllim dhe nuk mund të ketë qëllim tjetër.

Është thënë dy ditët e fundit që është ndërmarrë një veprim për të mbrojtur Kushtetutën e Republikës së Kosovë, për të mbrojtur sundimin e ligjit në gjithë territorin e Kosovës dhe nuk ka njeri, qytetar dhe përfaqësues i cili nuk e përkrah veprimin e tillë. Më në fund, edhe në bankat e këtij Parlamenti, jo vetëm në këtë legjislaturë, por në të gjitha legjislaturat që i ka prodhuar, të katërtat me radhë, deputetët partish politike, herë pozitë e herë opozitë, faktikisht e kanë thënë gjithmonë këtë frazë, që është bërë pak a shumë si një tip lutjeje, meshe e shahadeti, kështu që nuk themi asgjë të re sot nëse themi se duhet të zbatohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës në çdo pjesë të Republikës së Kosovës.

Pse është thënë kjo kështu? Është thënë kështu të shumtat herë se është ditur, siç dihet edhe sot, kur po flasim, që Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe shteti ligjor nuk vepron në një pjesë të territorit të Republikës së Kosovës. Puna pra është që të veprojnë edhe atje dhe në funksion të kësaj është edhe veprimi, vendimi që ka marrë Qeveria e Kosovës, më konkretisht edhe kryetari i Qeverisë, zoti Hashim Thaçi, më 25

korrik. Unë them që ajo që jetojmë sot pas datës 25, absolutisht nuk është e njëjta gjendje, absolutisht nuk do të jetë kurrë më e njëjta gjendje në Kosovë si ajo para të 25-tit. Këtu po karakterizoj, nuk po cilësoj kualitativisht çka ka ndodhur, po karakterizoj sepse rrjedhojat e saj do të prodhojnë diçka tjetër dhe mençuria jonë, edhe e Qeverisë, edhe e Kuvendit është: si do të veprojmë tutje që këto rrjedhoja të jenë të dobishme për Republikën e Kosovës dhe për qëllimet finale të saj për sovranitet, sundim të ligjit, demokraci në Kosovë. Kjo është fundamentale çka do të bëjmë dhe pse po bisedojmë sot, se edhe njëherë thashë, nuk kemi ardhur këtu as ta lavdërojmë, as ta rrënojmë dikë, se s'ka kurrfarë kuptimi ajo.

Ky veprim krejt legal dhe legjitim, unë mendoj për mbrojtjen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e ka edhe një finesë dhe unë dua ta nënvizoj këtu, vendimi prandaj duhet të jetë legal dhe në kuadrin e Kushtetutës, siç është qëllimi dhe kjo është shumë me rëndësi, në mënyrë që koordinimet për rrjedhojat të jenë funksionale dhe unë nuk dua të specifikoj më tutje këtu, sepse mendoj që në situata të tilla edhe konfidencialiteti ka funksion dhe unë jam në Kuvend, por unë e thashë atë që mendova dhe e nënvizova, sepse kurrgjë nuk është kryer, ngjarjet janë në zhvillim.

Për ta kuptuar pak më qartë, ne dhe ata që na dëgjojnë, ne duhet të themi, si ishte para të 25-tit, kush ishte në ato pika, çfarë funksioni kishte, çka ndodhi më 25 dhe çfarë gjendje është sot dhe kush është sot në ato pika, atëherë hyn analiza dhe bisedohet për rrjedhoja. Veprimi është kushtetues, veprimi është i kërkuar, qoftë me artikulime në këtë Kuvend, qoftë me kërkesën e qytetarisë së Kosovës, padyshim, por duhet të shohim çka ka ndodhur, sepse këtij veprimi konstitucional të Kosovës i është përgjigjur një kryengritje, madje kryengritje e armatosur dhe unë e shoh të këtillë, dhe duhet të cilësohet si e tillë. Unë nuk di qysh duhet të cilësohet tjetër kur ka situime armësh të rënda karshi një veprimi që ne po i themi dhe është konstitucional i Kosovës.

Çfarë na pret tash këtu? Nuk është mirë të kacagjelohe mi ose të fryhemi në gjuhën popullore, që themi ne, se na bëjmë këtë, këtë. Vullneti i qytetarëve të Kosovës edhe i qeverive në vazhdim dhe i Qeverisë Thaçi, padyshim është që Kosova të jetë e lirë në të gjithë territorin e vet dhe në gjeografinë e vet, padyshim dhe këtu nuk kemi çka tëhollojmë. Problemi është që edhe ky aksion ka treguar që Kosova e ka vullnetin, por nuk i ka kapacitetet, zonja e zotërinj, për ta bërë këtë veprim si e vetme. Prandaj, edhe një herë po them, t'i harrojmë trimërimet, që nuk ka nevojë për rrahagjoks, dhe të shohim që jemi në një situatë kur një pjesë e territorit të Kosovës ka filluar, përpos që është gjeografi, të bëhet metaforë politike, të përpiqemi të zbres nga cilësimi i metaforës politike, të jetë pjesë gjeografie e Kosovës, ku nuk sundon ligji dhe ky ligj të vihet në bashkëpunim, në koordinim me forcat që këtu janë të dërguara nga Kombet Bashkuara për ta ruajtur qetësinë dhe për ta ndërtuar stabilitetin. Emrat i dimë, nuk e kam ndërmend t'i citoj, se i di gjithkush.

Prandaj, mendoj që edhe kërkimi ynë sot këtu si parlament, është që nuk ka dorëheqje nga veprimet e fuqishme institucionale me të gjitha instrumentet dhe lidhjet e miqtë e Kosovës që të sundojë ligji në gjithë territorin e Kosovës, sepse nuk është mirë. Shiko, unë po përsëris, se e kam pas thënë edhe para dhjetë vjetësh këtu, ka histori kjo puna e

veriu, nuk është prej dje, as prej Qeverisë së Hashim Thaçit, as të asaj të parës, as të dytës, kjo ka histori. Kemi pasur ne atë sunduesin, Shtainerin, të parin këtu ka qenë, unë jam këtu që iu kam përgjigjur atyre pikave të famshme. Pata mbetur si vetëm, po koha ka qenë tjetër atëherë, tash besoj se nuk jetë i vetëm askush, pra nuk duhet tash as Thaçi të mbetet vetë, është historia dhjetëvjeçare, njëmbëdhjetë vjeçare. Nuk ka nevojë sot ta ndërtojmë këtë histori, ka nevojë që kjo histori të ndalet. Prandaj, po them, qëllimi, veprimi nuk guxon të ndalet. Mirëpo, veprimet duhet të koordinohen dhe të drejtohen rrjedhojat në mënyrë që mos të bëhet problem edhe i madh veriu, nuk ka të bëjë veç me kalljen e dy pikave kalimtare të objekteve, se ai është gjest kallja, një shtëpi e kall, e ndërton. Problemi është që mos të bëhet konflikt i pazgjidhshëm ajo. Kjo duhet të bëhet në koordinim me fuqitë që merren me Kosovën. Këqyre, në gjuhën popullore thotë, ju e dini, çdo shtëpi pa miq nuk jeton, edhe të mëdhatë, e kjo e jona është pak si e vogël, kështu që mendoj se është koha që institucionet të jenë të përgjegjshme, edhe qytetarët të përgjegjshëm.

Unë kam dhimbje deri në fund për një burrë të ri që ka vdekur atje në detyrë të vet edhe na e kemi shpallur... (unë e marrë kohën e Grupit, të lutem mos, më ndërpre, se nuk do të flasim edhe aq shumë). Pra, po them, ndiej dhimbje të madhe për një burrë, i cili ka vdekur dhe dhënë atje në detyrë dhe është shpallur edhe Hero, por unë po them, të gjitha nderimet për njerëzit e tillë, në të gjitha kohërat, veçse të fillojmë të provojmë ta ndërrojmë pak logjikën e fatalitetit të heroizmit shqiptar, unë po e quaj edhe ballkanik, se sa më shumë heronj, liri më shumë nuk ka. Tërë popujt që kanë shumë hero, zakonisht nuk e kanë lirinë. Përpiqemi të organizohemi, ta ndërtojmë lirinë pa shumë flijime. Kjo është thirrja ime për vetveten dhe për ju, si një parlamentar që jam bajagi gjatë në këto banka. Kështu që, besimi në vetvete, është besimi në institucione. Këtu institucione jemi të gjithë, si Kuvendi, si Qeveria, si Presidentja, si niveli i ulët, i pari, i dyti. Kështu që, nëse këtë besim e bëjmë veprim dhe, po them edhe një herë, mençuri, atëherë Kosova qysh e ka shpallur pavarësinë, të cilin edhe ashtu e kemi shpallur me marrëveshje, ju e dini, me veprime të koordinuara do ta fitojë edhe lirinë në gjithë territorin e vet dhe për gjithë banorët e vet.

Ne, natyrisht që do ta gjejmë mënyrën ta përkrahim një rezolutë, sepse ajo gati është pika formale e kësaj pune. Ne jemi mbledhur këtu, kujtoj edhe një herë sot, që të organizohemi seriozisht për të zgjidhur në dobi të Kosovës një gjendje që është e rëndë, nuk është lehtë.

Ju faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!
Radhën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Të martën në mëngjes, më 26 korrik, Lëvizja “Vetëvendosje” pati shprehur qëndrimin e saj përkitazi me vendimin e Qeverisë së Kosovës dhe nismën për vendosjen e kontrollit në pikat doganore 1 dhe 31 në veri të vendit.

Ne patëm thënë që ky vendim i Qeverisë është i kuptueshëm, i arsyeshëm dhe i drejtë. Thjeshtë, vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me 20 korrik për moslejimin e mallrave prej Serbisë në Kosovë, bëhej absurd dhe i pa zbatueshëm pa këtë vendimin tjetër, i cili e urdhëron policinë që t'i marrë nën kontroll pikat kufitare veriore. Mirëpo, në komunikatën tonë që mbante titullin: Kurrresi nuk bënë të zmbrapsemi tash, thuhej që me këtë rast shpresojmë që nuk është menduar vetëm hapi i parë. Shpresojë që Qeveria ka nisur me zbatimin e një plani, të një strategjie më të gjerë për ta bërë Kosovën sovranë e me integritet territorial.

Nëse është menduar vetëm hapi i parë, atëherë mund të bëhet edhe më keq seç ka qenë deri më tash. Nëse nuk vazhdohet me ofensivë të vendosur deri në fund, pikat e marra nën kontroll mund të mos mbrohen gjatë. Hapi i këtillë është pozitiv dhe i drejtë, por hapi mbetet veç se një hap. Hapi nuk e bënë ecjen, ecjen e përbëjnë hapat, shumë hapa të bashkërenduar. Dhe më tutje kemi vazhduar: Sidoqoftë, pra sidoqoftë, edhe nëse Qeveria e Kosovës nuk ka menduar më shumë e më gjatë se sa hapin e parë që e ndërmoi, mungesa e planit dhe strategjisë duhen kompensuar me thirrjen e domosdoshme që Qeveria dhe Presidentja duhet t'ia bëjnë gjithë popullit dhe shoqërisë sonë në mbrojtje të Kosovës në këto momente të jashtëzakonshme.

Populli dhe qytetarët e Kosovës, Qeveria dhe organet më të larta shtetërore, duhet të jenë në gjendje gatishmërie për njëri - tjetrin dhe së bashku të gatshëm për Kosovën. Ajo çfarë ndodhë ose nuk ndodhë brenda disa ditëve, në kohëra si kjo, kollaj mund të përcaktojë periudhat e tëra prej disa dekadave më pastaj. Dhe, në fund kemi thënë që shteti i Kosovës kurrresi nuk bënë të zmbrapsemi tash. Populli dhe institucionet e Kosovës tash duhet të jenë vigjilentë dhe të organizuar për ta mbrojtur Kosovën, për ta mbështetur pa kursim Policinë e Kosovës që e mbron Kosovën.

Organizimi i përbashkët i popullit, i institucioneve dhe i subjekteve politike e shoqërore do ta përshpejtonte dhe lehtësonte fitoren. Lëvizja “Vetëvendosje, kemi thënë të martën, herët në mëngjes, me të gjithë aktivistët dhe anëtarët e saj është e gatshme dhe shumë e interesuar që të kontribuoj për këtë. Tash është koha që institucionet më të larta shtetërore të mos administrojnë teknikisht, por të prijnë politikisht.

E pamë që Policia e Kosovës, me ndërhyrjen e saj ka dëshmuar se është e mundur që këto pika të vihen nën kontrollin e institucioneve të Kosovës. Të gjithë ata të cilët kanë shprehur dyshime, kanë qenë skeptik se është e pamundur të merren ndonjëherë pikat 1 dhe 31, Policia e Kosovës me njësitë speciale ua ka dëshmuar të kundërtën. Pra, ishte e mundur dhe u bë e mundur që të merren pikat 1 dhe 31. Hapi i tillë ishte i drejtë dhe me sukses u realizua. Mirëpo, duket që Qeveria nuk kishte plan me disa hapa, por më parë ajo pati veçse një hap, pa plan. Dhe, kështu, përkundër gatishmërisë së popullit, policisë dhe mekanizmave tjerë shtetërorë të Kosovës për të vendosur rendin dhe ligjin në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, me gjasë, thjeshtë, Qeveria nuk ishte e gatshme për këtë gatishmëri.

Pra, gjatë këtyre 12 vjetëve nuk kishim një ndërhyrje të këtillë, jo pse e kishim policinë e paaftë, as pse policia jonë nuk paska kurajo. Përkundrazi, aftësia, kapacitetet, kurajoja

e policisë, gatishmëria e saj, përgjegjshmëria dhe vetëmohimi edhe si qytetar, edhe si zyrtar, u dëshmuar se kanë qenë aty. Ka munguar vullneti dhe urdhri politik i njerëzve që janë në majë të institucioneve, e posaçërisht të Qeverisë.

Dhe, edhe më tutje ekziston kjo gatishmëri dhe kjo aftësi, por edhe më tutje duhet të ekzistojë gatishmëria e Qeverisë së Republikës së Kosovës që të mos zbrapsemi. Nëse e ndalë ofensivën, nëse pushon me iniciativë, atëherë duhet ta përjetosh ofensivën dhe iniciativën e të tjerëve. Mos harroni se nuk na i kanë djegur pikat doganore 1 dhe 31 më 17 shkurt të vitit 2008, na i kanë djegur të pasnesërmen, më 19 shkurt, atëherë kur në Prishtinë dhe gjithandej nëpër Kosovë festohej.

Njësoj, me 12 qershor të vitit '99, është festuar në Prishtinë dhe nëpër Kosovë tërheqja e forcave të Serbisë dhe hyrja e NATO-s. Pak ditë më vonë u nda Mitrovica. A thua se festimi është mallkimi ynë. Pra, duhet të jemi vazhdimisht vigjilentë, të organizuar, të mobilizuar për shkak se në momentin kur relaksohesh, në momentin kur ke eufori, pesimizëm ose skepticizëm, ajo është shans e përsosur për kundërshtarin. Dhe, për këtë ne kemi bërë thirrje, kemi shprehur gatishmërinë tonë, të të gjithë aktivistëve tonë dhe kemi kërkuar organizim të gjithmbarshëm të qytetarëve, të institucioneve dhe të subjekteve, në mënyrë që të mbështetet Policia që po e mbron Kosovën dhe vetë të funksionalizohemi brenda planit shtetëror për ta mbrojtur Republikën e Kosovës.

Por, edhe pse, pra, ne nuk ishim të njoftuar e të ftuar në planifikim, as në vendim e as në zbatim, ne kemi shprehur këtë gatishmërinë tonë dhe ajo çfarë fituam, në fakt, është se Qeveria ka vazhduar të veprojë e vetme, e vetmuar, pa ndonjë plan, prandaj edhe mendojmë që ka ardhur në një situatë ku më shumë po e bën të kundërtën e asaj që thamë ne, pra nuk po vepron që të mos zbrapset, por po negocion dhe vazhdon ta negociojë zbrapsjen. Policia e Kosovës dhe njësitë e saj në veri nuk janë zbrapsur prej strukturave ilegale të Serbisë atje, por ato janë tërhequr me urdhrin e Kryeministrit dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, përkatësisht të ministrit të Brendshëm.

Ne duhet ta definojmë se çka është sukses dhe cilat janë objektivat tona, çka duam ne në veri të Kosovës? Duam që t'i marrim nën kontroll pikat doganore 1 dhe 31, mirëpo kur themi t'i marrim nën kontroll, besoj që nuk po e mendojmë KFOR-in, sepse KFOR-i ka qenë në pikat 1 dhe 31 edhe para shpalljes së pavarësisë, edhe pas shpalljes së pavarësisë. KFOR-i po e zbaton Rezolutën 1244, dhe a e dini pse KFOR-i është tash në pikat 1 dhe 31? Sepse është i interesuar që ta mirëmbajë kufirin me Serbi, si kufi administrativ. KFOR-i po e mbron Rezolutën 1244, ne duhet ta mbrojmë pavarësinë, nuk e mbron KFOR-i pavarësinë. Dhe, kufiri me Serbinë, bëhet kufi ndërshtetëror, jo me KFOR-in atje, por me Policinë e Kosovës, me njësitë speciale të Policisë së Kosovës dhe me doganat e Republikës së Kosovës. Kur them me Policinë e Kosovës, nuk mendoj me serbë, sepse përvoja e ka treguar që serbët në Policinë e Kosovës në veri formalisht punojnë për Kosovën, por përmbajtësisht marrin direktivat dhe pagat nga Beogradi.

Tjetra, kisha dashur të tërheq vërejtjen se nuk bën ato grupe kriminale në veri, ato struktura të Serbisë atje që quhen vagabondë. Vagabondët janë ata që bëjnë dhunë pa arsye, në stilin e tifozëve të hidhëruar, kur humbet ekipi i tyre në stadium edhe kur dalin prej andej, thyejnë disa makina, ata janë vagabondë. Në veri nuk kemi vagabondë, në veri kemi dhunë sistematike të planifikuar dhe të organizuar prej shtetit të Serbisë, dhe duke i quajtur vagabondë, ne eventualisht i fyejmë ata, por ne e zbresim krimin e tyre me këtë cilësim.

Tjetra, nuk mendoj që është demaskuar Serbia. Serbia karshi shqiptarëve nuk ka pasur kurrfarë maske, Edhe sa herë duhet të na vrasin ata neve, edhe sa herë duhet të na dëgjin ata neve, që ne ta marr vesh se kush është Serbia. Kushdo që ka lexuar pak histori, Kushtetuta e Republikës së Serbisë, projektet e tyre tradicionalisht dhe aktualisht antishqiptare, tregojnë që Serbia është armik i yni dhe në këtë kuptim, Lëvizja “Vetëvendosje” e ka quajtur Serbinë shtet armik, për dallim prej politikanëve qeveritarë që e preferojnë shprehjen “vend fqinj”. Prandaj, edhe në përputhje me fjalimin e kryeministrit sot, ju kisha lutur që tash e tutje kur të mos e quajmë Serbinë vend fqinj, sepse nuk është i tillë, por ta quajmë shtet armik, ashtu siç e ka shpallur ajo vetën karshi nesh. Nuk është se ne po e shpallim armik, ajo e ka shpallur veten dhe fjalët kanë rëndësi, sepse fjalët identifikojnë probleme, mobilizojnë njerëz dhe mundësojnë veprime.

Në fund...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, vazhdoje!

ALBIN KURTI... Në fund, edhe një herë desha të theksoj që propozimi i Lëvizjes “Vetëvendosje” është që, në përputhje me rrethanat aktuale, kur Kosovës i është dëgjur kufiri në veri, Presidentja e Republikës së Kosovës ta shpallë gjendjen e jashtëzakonshme dhe më pastaj të ndodhë organizimi dhe aktivizimi i të gjitha resurseve qytetare, institucionale, në përputhje me atë gjendje.

Tjetra, gjithashtu ta bëjmë ndërprerjen përfundimtare të menjëhershme e zyrtare të këtyre bisedimeve me Serbinë, të cilave kurrë nuk do t’ua shohim hairin. Përkundrazi, vetëm do të përfitojë Serbia, e ne duke biseduar pa parime e pa kushte për Serbinë, do t’ia mirëmbajmë apetitet Serbisë. Dobësia jonë është gravitet për apetitet e Serbisë.

Tjetra, menjëherë institucionet shtetërore të Kosovës, Presidentja dhe Qeveria e Republikës së Kosovës duhet ta intensifikojnë bashkëpunimin, mbase t’i mbajnë telefonat hapur me Republikën e Shqipërisë, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me shtetet e BE-së që na kanë njohur dhe me Turqinë për shkak se sovraniteti nuk falet, askush nuk ta jep sovranitetin. Sovraniteti merret, ai na takon neve, por atë duhet ta fitojmë. Të tjerët na ndihmojnë, por nuk mund ta zëvendësojnë angazhimin tonë vetjak. Këmbëngulësia jonë, sinqeriteti, serioziteti jonë, do t’i rrisë edhe miqtë tanë.

Dhe, së fundi, është e domosdoshme që institucionet e Kosovës të bëjnë debat pa kufizime në Kuvendin e Kosovës, bashkë me Qeverinë për një strategji se si t'i maksimalizojmë efektet tona dhe Kosova qysh është formalisht e pavarur, të bëhet edhe përmbajtësisht e tillë nëpërmjet sovranitetit dhe integritetit territorial. Unë e kuptoj që mund të ketë gjëra të cilat nuk janë lehtë të thuheshin tash për shkak se zhvillimet po ndryshojnë nga ora në orë, por dihet që nga praktika parlamentare Kuvendi mund të mbajë edhe seanca të mbyllura, por është i domosdoshëm koordinimi, është e domosdoshme vendosmëria dhe këmbëngulësia, sepse përndryshe gjendja do të bëhet edhe më e keqe seç ishte.

Mendojmë që ka shanse për përmirësim, ka shanse për avancim, sepse populli shqiptarë sot në Kosovë, dhe jo vetëm në Kosovë, moti nuk ka qenë kaq i bashkuar, siç është tani. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti Arsim Barjami.

ARSIM BAJRAMI: I nderuari zoti kryetar i Kuvendit,
I nderuari zoti kryeministër,
Zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Para se të diskutoj, dëshiroj t'i bëjë dy citime të shkurta të Kushtetutës të Republikës së Kosovës për shkak se edhe diskutimi im lidhet me këto citime.
Neni 1, pika 1 e Kushtetutës të Republikës së Kosovës e definon Republikën e Kosovës si shtet sovran, të pavarur, demokratik, unik dhe të pandashëm.

Neni 2, pika 2 e definon sovranitetin e Kosovës dhe sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës si të pandashëm dhe të patjetërsueshëm dhe përcakton se mbrojtja e sovranitetit është e lejuar me të gjitha mjetet e përcaktuara me Kushtetutë.

Në kuptim të këtij citimi, unë mendoj se veprimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është një veprim kushtetues, është një veprim legjitim në mbrojtje të interesave vitale kushtetuese të Republikës së Kosovës, për aq më tepër nuk e quaj si një veprim të thjeshtë qeveritar të ekzekutivit, i cili edhe ka detyrim ta marrë këtë veprim karshi qytetarëve që e kanë zgjedhur për ta udhëhequr vendin, po e quaj si një veprim shtetëror, si një veprim të dinjitetshëm shtetëror në mbrojtjen e vlerave fundamentale të shtetit të Republikës së Kosovës.

Me këtë veprim, Qeveria ka demonstruar gatishmërinë, guximin dhe vendosmërinë që në fakt të vendos realizimin e plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, realizimin e plotë të parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe ka treguar që në fakt durimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, durimi i shtetit të Kosovës në pritjet që i ka që partnerët tanë ndërkombëtar të veprojnë, nuk mund të jetë i pa afatizuar dhe është një kohë kur ne duhet të tregojmë vendosmëri edhe për faktin që kjo vendosmëri dhe kjo qasje realiste e shtetit tonë, jo gjithëherë po shpërblehet me veprimet e faktorëve të tjerë që kanë marrë obligim, e për aq më tepër që

kanë njohur Republikën e Kosovës, sepse të nderuar kolegë, ka 12 vite që ne po jetojmë me një realitet, me një realitet ku një pjesë e territorit të Republikës të Kosovës është jashtë ligjit, një pjesë e territorit të Republikës së Kosovës është burim potencial i agresioneve, i destabilizimit apo i sabotazhave të një shtetit të ri dhe ne për 12 vite kemi pritur që bashkë me aleatët tonë ndërkombëtarë, me të cilët kemi ndërtuar shtetin, atë pjesë të territorit të Republikës të Kosovës ta vendosim në suaza të ligjit, në suaza të veprimit shtetëror.

Në kohën kur ne në bisedime kemi treguar një kurs të moderuar, kemi përqaftuar një agjendë evropiane, jemi treguar fleksibil, ne po shohim këto ditë politikat e njëjta të Beogradit, politika që asnjëherë nuk kanë ndryshuar dhe politika që gjithmonë janë shoqëruar me agresione, me agresione kushtetuese.

Jo rastësisht u tha edhe nga parafolësit se grupet vandale që i pamë, nuk janë grupe vandale, nuk janë tifoz të futbollit, nuk janë rrugaçët, por janë manifestim i denjë i politikës së vërtetë serbe, të Qeverisë së Serbisë, e cila përmes destabilizimit, përmes agresionit kushtetues asnjëherë nuk i ka fshehur apetitet për përfitime territoriale, për ndarje territoriale dhe kjo bie ndesh edhe me porositë politike të lidershipit serb. Jo rrallë na ka rënë të dëgjojmë që në fakt, duhet të jetë këtu një zgjidhje. Pavarësia është e pakthyeshme, por kemi parë nga kreu serb, nga lidershipi serb që serbët duhet të marrin atë që mund ta marrin, nëse nuk kanë mundur ta mbajnë Kosovën të tërë, politika aktuale serbe tenton që përmes veriut ta destabilizojë shtetin.

Kështu që, ky veprim i Qeverisë është një kthim dhe unë mendoj se e tha mirë edhe profesor Hamiti, nuk ka kthim mbrapa. Nuk e quaj akt të vonuar të Qeverisë, përkundrazi Qeveria ka koordinuar me partnerët ndërkombëtarë që kanë obligime, kanë obligime që të vendosin ligjin. Ne i kemi bërë vetë ftesë misionit evropian që të ndihmojë shtetin e ri të Republikës së Kosovës për vendosjen e standardeve evropiane sa i përket sundimit të ligjit. Nëse kemi bërë përparime në territorin e Kosovës, atëherë në këtë pjesë të Kosovës jemi shembulli më i keq i sundimit të ligjit, sepse atje veprojnë dhe tolerohen veprimet më të ndryshme të shkeljes së ligjit, të shkeljes së Kushtetutës, veprime këto që në fakt e kanë destabilizuar dhe e ka penguar shtetin e Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë,

Ky veprim i Qeverisë, që po merr përkrahje të gjerë edhe politike, edhe qytetare, është një hap i mirë që ne të krijojmë politika shtetërore. E thashë edhe më parë, nuk është vetëm përgjegjësi e Qeverisë, por përgjegjësi e të gjitha institucioneve që të krijojnë politika të vendosura shtetërore në mbrojtjen e interesave shtetërore. Natyrisht, ne duhet të koordinojmë me partnerë ndërkombëtarë, me të cilët kemi lidhur aleancë që nga çlirimi, pavarësia e deri te subjektet tjera, por të tjerët do të kenë respekt aq sa ne jemi të vendosur dhe ne duhet të jemi të vendosur që vërtet të mbështesim Qeverinë, e cila edhe e ka marrë mandatin nga ky parlament që të qeverisë, të mbështesim Qeverinë në aksione të mëtejshme dhe vendosja e kontrollit në pikat doganore le të jetë vetëm hapi i parë drejt vendosjes së fuqisë së ligjit dhe kushtetutës në atë pjesë, sepse ky është vetëm një dimension për shkak se ka edhe shumë veprime tjera në shpërbërjen e strukturave

paralele, në themelimin e institucioneve relevante kushtetuese të cilat veprojnë në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe jam i sigurt se edhe Qeveria e Republikës së Kosovës këtë do ta trajtojë vetëm si një hap i parë dhe drejt krijimit të politikave adekuate shtetërore të cilat do të na mundësojnë që, vërtet, me një dinjitet shtetëror të veprojmë në atë pjesë dhe në këtë mënyrë të mbrojmë interesat tona shtetërore. Kështu që unë mendoj që të gjithë duhet të bashkohemi rreth këtyre politikave shtetërore dhe krijimit të këtyre politikave shtetërore dhe si shtet i koordinuar ne të veprojmë me kërkesa të qarta, me kërkesa të vendosura, me kërkesa të qarta për shkak se 4 vite pas pavarësisë ka ardhur koha që vërtet pavarësia të jetësohet në gjitha pjesët e Kosovës.

Dhe, së fundi mendoj, se krahas veprimeve tjera, krahas shpalljes së pavarësisë, krahas miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, personalisht vlerësoj se ky moment politik paraqet momentin më të rëndësishëm që vërtet sovraniteti i Republikës së Kosovës të realizohet plotësisht, të vendoset plotësisht parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, sepse një shtet ku sundon ligji, një shtet ku ka kushtetutshmëri dhe ligjshmëri, është një shtet që mund të integrohet në Bashkimin Evropian dhe kjo është edhe një arsye se gjithë partnerët ndërkombëtarë, gjithë aleatët tanë të kuptojnë këtë se një Kosovë ku sundimi i ligjit vepron për të gjithë edhe ndaj të gjithëve, sundimi i ligji dhe kushtetuta vepron në tërë territorin e Kosovës, është një Kosovë çfarë edhe ata duhet ta shohin në të ardhmen, një Kosovë evropiane që vepron plotësisht me parime evropiane. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri!

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zoti kryeministër, anëtarë të Kabinetit,

Të nderuar deputetë,

Ne po flasim për një vendim të Qeverisë, i cili është sjellë, është zbatuar në kuptimin e zbatimit të urdhrit më 25 korrik dhe duke pasur parasysh vështirësitë që kanë dalë në zbatimin e operacionit nga ana e atyre që janë përgjegjës, në këtë rast policia e shtetit, tregon qartë që këto dy episode të vendimmarrjes dhe të zbatimit të vendimit, në këtë rast në marrjen nën kontroll dhe vendosjen e ligjit në kufirin në pjesën veriore të portës 1 dhe 31, nuk ishte i lehtë. Natyrisht që Serbia, sikur çdo rast tjetër, edhe tash përmes treshes apo reagimit mbas tri ditëve tregoi qartë që ka përcjellë me kujdes zbatimin e këtij vendimi për të ndërtuar kundër masat apo për të ndërtuar reagimin. Edhe më 2 korrik të vitit '90 Serbia ka reagua më 5 korrik, edhe më 17 shkurt ka reagua më 20. Domethënë, gjithçka në raport me lëvizjen tonë, me vendimin tonë dhe me angazhimet tona, reagimi i Serbisë këto 20 vjetët e fundit është i bazuar në politikën e kundërmasave, si pasojë e pritjes të durueshme për të parë se çka po ndodhë apo se çka po ecën në këtë drejtim.

Ne duhet ta konstatojmë edhe një herë gjendjen se aspirata territoriale e Serbisë ka tejkaluar kësaj here mundësinë që oferta jonë e dhënë në pakon e Ahtisarit për vetëqeverisje lokale të qëndrueshme dhe të fortë është e papranueshme dhe si e tillë nuk është funksionale për këta njerëz. Aspirata e saj territoriale tash bazohet në 17% të territorit të Republikës sonë, e të banuar nga vetëm, më pak se 5% të popullatës. Një

territori i madh, me dendësi të vogël dhe me mundësi që operacionet apo dirigjimi i operacioneve të jetë i madh.

Grupet e të rinjve dhe të njerëzve dirigjuar kanë qenë ata që kanë marrë koktej të Mollotovit edhe sopatat në dorë, ndërsa të mbuluara me ekipe të armatosura në prapavi, si siguri e madhe që këto pika edhe një herë të digjen si kundër reagim, herën e parë ndaj vendimit apo deklarimit të pavarësisë së Kosovës dhe herën e dytë ndaj vendimit dhe zbatimit të këtij vendimi të Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Fokusi ynë në përmirësimin e gjendjes përmes dialogimit dhe përmes ndërtimit të mekanizmave të tjerë të zbatimit të mbështetjes së madhe, diskriminimit pozitiv, subvencioneve të mëdha financiare, atraktivitetit në mënyrave të ndryshme, tregoi qartë që është i pamjaftueshëm karshi mundësisë që tjetërkush t'i dirigjojë dhe tjetërkush të vendos për këta njerëz.

Atëherë, dialogu me opozitën është më i rëndësishëm në këtë fazë se sa dialogu me tjetërkënd. Një mungesë e theksueshme e dialogut me opozitën ka bërë që ne të na lënë jashtë njohurisë, të njohurive për një operacion të tillë, nuk po flasim këtu për grupe parlamentare, po flasim për institucione dhe besojmë shumë që një dialog i tillë do t'i kontribuonte jashtëzakonisht shumë mbarëvajtjes dhe zbatimit të vendimeve në të afërme, sepse sundimi i ligjit, vendosja e kushtetutshmërisë dhe funksionaliteti i shtetit është interes kombëtar për të gjithë ne.

Nuk jam i primë sot të flas sot për analizë se çka dhe se si mund apo do të bëhej më mirë, sepse besoj që pas një kohe do të arrijmë të punojmë në këtë drejtim më shumë, por jam i primë të sugjeroj që të nxirren mësimet e marra nga ky operacion dhe vërtet të arrijmë ta zbatojmë qëndrimin tonë politik dhe ta detyrojmë funksionimin e shtetit në çdo pjesë të territorit. Nuk është detyrë e lehtë, sikur që nuk ka qenë vendimi i lihtë. Vendimi ka qenë jashtëzakonisht i rëndë, edhe zbatimi i vendimit doli jashtëzakonisht i rëndë, por i mundshëm. Si mision i tillë, besoj që nuk guxon të lejojmë që të na zmbraps asnjëherë.

Në fund, unë e kuptoj që Njësia Speciale e Policisë së Shtetit ka reagua në ato pika ku e kemi hetuar mungesën e Policisë së EULEX-it. Dërgimi i kësaj njësie ka qenë më shumë krijimi i besimit që misionet tjera të mandatuara nuk guxojnë dhe nuk mund të tolerojnë që mos të zbatohen vendimet e shtetit të Kosovës. Një disiplinim në zbatimin e këtij vendimit është parë, besoj, dhe ajo që nuk është parë disiplinim në këto dy episode të tri ditëve, kanë qenë disa nga anëtarët e Kabinetit të Qeverisë, kanë shkaktuar konfuzion, mungesa që njeriu kompetent, ministri i Punëve të Brendshme të japë sqarime të rregullta, siç e donë rrethanat e tilla, duke njoftuar publikun dhe qytetarin, ka krijuar mundësinë që disa nga ministrat me telefon në rrethana të caktuara ta kualifikojnë operacionin se në çfarë shkalle ka mbërri dhe si po zbatohet, kur gjithë ne e dimë që s'kanë pasur asnjë lloj njohurie dhe shkaktimi i një konfuzioni në publik është masa më e rrezikshme që dikush mund ta bëjë, sepse mungon shumë pak që reagimi qytetar të ndodhë, i përmasave më të mëdha se të vitit 2004. Ky është mësimi më i madh që sot duhet ta kemi para sysh.

Në fund, zoti kryeministër, si deputet dhe si anëtar i këtij Kuvendi, besojmë shumë që zbatimi i këtij vendimi do të jetë rrugë pa kthim dhe rrugë me një drejtim, nën një. Dhe, nën dy, mbështetja jonë është parimore dhe në momentin e parë që do të flasim për një analizë të mundshme, do t'i japim edhe vërejtjet dhe sugjerimet tona në kuadër të një procesi të dialogimit.

Dhe, në fund, shpresoj shumë që të mos ndodhë asnjëherë që në operacione të tilla të bien pre policët, ushtarët apo edhe qytetarët tanë, sepse çdo veprim i madh, çdo operacion i madh i ka edhe pasojat e veta. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!
Deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën!

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!
Zonja dhe zotërinj deputetë,
Më lejoni që të ndaj me gjithë ju shqetësimin tonë për atë çka po ndodhë në verri, duke vlerësuar situatën e sigurisë në veri si një situatë shumë të jashtëzakonshme, si një situatë e cila ndoshta për ne akoma jo, po sidomos për Forcat e Sigurisë Ndërkombëtare është një situatë tejte e jashtëzakonshme, e cila i ka bërë ata që ta rritin shkallën e gatishmërisë në pikën më të lartë të mundshme.

Po ashtu, gjendje të jashtëzakonshme të ashtuquajtur kanë shpallur edhe institucionet paralele të Serbisë në Kosovë, kemi ngelur vetëm ne, që ndoshta me dashje apo pa dashje gjithë kësaj situatë mundohemi t'ia japim natyrën e një gjendje të qetë e të zakonshme, gjendje e cila as përafërsisht nuk është e zakonshme dhe as përafërsisht nuk është e qetë, sidomos në territorin e veriut të Kosovës.

Për aq sa u tha, mendoj që institucionet e Kosovës kanë nevojë të jenë shumë më të informuara lidhur me atë çfarë po ndodhë dhe sidomos me atë çfarë po përgatitet të ndodhë në veriun e Kosovës, si iniciativë e forcave paralele të dirigjuara, siç u tha këtu, nga Beogradi. Pra, atje po ndodhë mobilizimi i serbëve në një të ashtuquajtur mobilizim të përgjithshëm, e cila i ka bërë të gjithë serbët të jenë tashmë të armatosur, të pajisur me mjete luftarake dhe me teknikë luftarake, e cila tashmë përveç se e rrezikon rendin dhe ligjin në veri, atje rrezikon edhe forcat ndërkombëtare, forcat e KFOR-it, kur kihen parasysh mjetet dhe tipat e llojet të armatimit çfarë ata i kanë tashmë në duart e tyre, në gjendje të gatshme të veprimi.

Mendoj që institucionet e Kosovës, ndoshta Qeveria e Kosovës dhe drejtpërdrejtë kryeministri do të duhej ta kishte pyetur pak më shumë AIK-un për gjendje se çfarë po përgatitet atje dhe për tendencën e tyre luftarake dhe politike çfarë e kanë serbët në veri.

Serbët në veri tashmë janë në gjendje lufte dhe ballafaqimi i tyre me forcat e KFOR-it po thuhet se tashmë ka vërtetuar se edhe KFOR-i, edhe serbët atje janë në gatishmëri lufte.

Nuk dua të ndjellë luftë me këtë çfarë unë po tërheq vëmendjen këtu, por ne duhet të jemi shumë të ndërgjegjshëm dhe të vetëdijshëm se çfarë po ndodhë atje dhe nganjëherë më falni që po ju them, por nganjëherë nuk duhet ta luajmë rolin e ëndrrës së gomarit.

Në të njëjtë kohë, më lejoni t'i ndaj me ju të gjitha ato informacione që i kemi sa i përket llojit të armatimit çfarë kanë atje. Për ata që kanë qenë në luftë, sidomos për ata të cilët duhet ta dinë dhe t'i njohin arsenalet e armatimeve, atje ka armë të cilat tashmë janë mobilizuar dhe armë me të cilat janë mobilizuar të ashtuquajturat njësitë për mbrojtjen e Kosovës në veri, armë të cilat siç thashë edhe më herët, rrezikojnë jo vetëm territorin e Kosovës, jo vetëm civilët e pambrojtur atje, por rrezikojnë edhe forcat e KFOR-it për shkak se atje ka të sistemuara postblloqe në pika të ndryshme dhe po ashtu ka edhe armë anti-tank dhe kundër ajror.

Në të njëjtën kohë, më lejoni edhe të solidarizohem me gjithë sakrificën e policëve të Kosovës të cilët janë atje, të cilët po bëjnë sakrificë shumë të madhe, sakrificë deri në heroizëm, ashtu siç u dëshmuar edhe me dhënien e jetës së njërit nga ata, dhe po ashtu të solidarizohem me dhimbjen e familjes së policit Hero të vrarë dhe po ashtu edhe me shqetësimin e gjitha familjeve të cilët i kanë policët atje në gjendje të gatshme për ta mbrojtur sovranitetin e Kosovës.

Qeverisë, siç u tha këtu, i kemi dhënë mbështetje dhe do të vazhdojmë t'i japim mbështetje one-way, me një drejtim, pra ne nuk mund t'i japim Qeverisë mbështetje dy drejtimesh, vajtje dhe ardhje, për shkak se kthimi i Qeverisë në ndërmarrjen e saj, të cilën ne e kemi mbështetur, nuk do të thotë kthim në pikën zero, por kthimi i Qeverisë nga ndërmarrja e saj do të thotë kthim në regres. Ne nuk duam ta paragjykojmë kthimin e Qeverisë, por duam edhe një herë t'ia tërheqim vërejtjen se çdo kthim prapa do të ballafaqohet me kundërshtimin tonë të drejtpërdrejtë politik dhe do të ballafaqohet po ashtu edhe me kundërshtimin e qytetarëve, të cilët duan që të mbrojnë sovranitetin e Kosovës në çdo pjesë dhe në çdo pëllëmbë të Kosovës.

Në anën tjetër, po ashtu, më lejoni të ndaj me ju edhe shqetësimin e policëve dhe të njësive sidomos që janë atje, të cilët nganjëherë nuk e kanë shumë të qartë me urdhrat politikë që vinë, sidomos për tërheqje dhe veprim, ndoshta edhe si pasojë e urdhrave të tillë ne kishim edhe humbjen e një polici për shkak se lëvizjet nganjëherë nuk kanë qenë gjithmonë të koordinuara mirë në aspektin profesional. Sidoqoftë, prapë se prapë shqetësimi i policëve, sidomos i njësive elite që janë atje, është jo frika e tyre, jo mos gatishmëria e tyre, por ata duhet ta kenë shumë të qartë me atë çfarë me çfarë janë të rrethuar atje dhe duhet ta kenë shumë të qartë me urdhra që u jepen atyre.

Në të njëjtën kohë, ne edhe si grup parlamentar, por si qytetar të Kosovës, normalisht që nuk jemi këtu vetëm të japim vërejtje dhe të japim analiza, sepse analizat do t'i japim shumë më vonë, do të ketë vend edhe për analiza profesionale, por ne sot jemi këtu që të japim edhe rekomandimet tona, ashtu siç u tha nga parafolësit e mi të grupit tim parlamentar. Pra, rekomandimet të cilat u dhanë deri në shkallën e ngritjes së gatishmërisë së vendit dhe deri në shkallën e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë, si e drejtë e jonë kushtetuese dhe në përputhje me Kushtetutën e Kosovës tashmë

janë plotësuar kushtet që të shpallim një gjendje të jashtëzakonshme në vend. Por, në anën tjetër, edhe në rrafshin profesional mendoj se Qeveria ka menduar shumë mirë ose nëse se ka menduar deri më tani, duhet ta mendojë që ta ngrejë në shkallën më të lartë të gatishmërisë Qendrën e Situatave dhe po ashtu ta mobilizojë Këshillin Kombëtar të Sigurisë, një këshill i cili duhet së paku tash e tutje ta justifikojë qenien e tij.

Në anën tjetër, mendoj që një kontakt më i drejtpërdrejtë, e theksoj, një kontakt më të drejtpërdrejtë, se nganjëherë fatkeqësisht ka munguar edhe kontakti, duhet të jetë me Forcat e Sigurisë së Kosovës, të cilat po ashtu kanë ngritur shkallën e sigurisë në nivelin më të lartë dhe me Policinë e Kosovës, e cila po ashtu jo vetëm në veri, po kudo në Kosovë është në shkallën më të lartë të sigurisë. Që ata ta kenë të qartë më mirë se çfarë duhet të bëjnë, nuk do të thotë që të bëhet publik plani operativ, por gjithsesi ata duhet të kenë plan operativ. Në të njëjtën kohë, unë mendoj që jo vetëm ta rishqyrtojmë raportin tonë me EULEX-in, raport të cilin ne e kemi kundërshtuar qysh edhe me qenien e tij këtu, por mendoj që tashmë Qeveria është e bindur që EULEX-i nuk është në të mirën e Kosovës dhe duhet të reflektojë në përputhje me këtë gjendje çfarë tashmë EULEX-i i ka ndihmuar Qeverisë së Kosovës që ta tregojë mosgatishmërinë e EULEX-it në mbrojtje të shtetësisë dhe të sovranitetit të Kosovës.

Nga përvoja jonë e kemi shumë të qartë që Serbia nuk është aq e fortë as në Serbi atje, pale as në Kosovë sa që të mos të mund të zbrapset nga agresioni që ka marrë kundër sovranitetit të Kosovës.

Pra, se sa është Serbia e fortë, ne i kemi dëshmuar Serbisë edhe kur ka qenë këtu me tanke, edhe kur ka qenë këtu me aeroplan, edhe kur ka qenë këtu me të gjitha forcat e sigurisë, me ushtri dhe polici, përfshirë edhe paramilitarët. Pra, ne kemi kapacitetet tona, Policia e Kosovës ka kapacitete që t'i kundërpërgjigjet që çdo lloj agresioni që bën Serbia ndaj Kosovës dhe rrjedhimisht ne kemi kapacitete dhe dëshmuam Policia e Kosovës që ka mundësi të vihet rendi dhe ligji atje, nëse nuk i mungon përkrahja politike nga institucionet e Kosovës.

Në të njëjtën kohë, ne duhet ta manifestojmë edhe një herë forcën tonë ligjore kundër forcës së paligjshme në këtë vend. Pra, mbrojtja e vendit nuk është më vetëm dëshirë, por është detyrë dhe po ashtu sovraniteti nuk duhet të ketë kompromis me asnjë qoftë marrëveshje apo me asnjë lloj negociatash rreth sovranitetit. Dhe njëkohësisht edhe një herë, përveç se është Serbia dhe duhet shpallet agresor në Kosovë dhe po ashtu përgjigja jonë për reciprocitet nuk duhet të jetë vetëm në rrafshin e tregtisë dhe mallrave, por reciprocitetin Serbia duhet ta ndjejë në çdo fushë që ata veprojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!
Shaip Muja e ja fjalën!

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues i Kuvendit,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,

Ne, momentalisht, para 3 ditësh kemi parë implementimin ligjor dhe të drejtën kushtetuese të Qeverisë së Republikës së Kosovës për të bërë shtrirjen në tërë territorin e saj dhe për të plotësuar obligimet ndaj qytetarëve dhe ndaj një standardi i cili është i domosdoshëm për kërkesën që parashtrohet edhe nga faktorët evropianë që Kosova nesër të jetë faktor i integritetit dhe i stabilitetit. Ky stabilitet u atakua dhe ne shpeshherë kemi biseduar në këtë Kuvend, duke atakuar edhe dialogun, ku ne kemi qenë konstruktiv, kemi qenë parimorë për interes të qytetarëve të dy vendeve dhe ky, në këtë mënyrë, kjo qasje që bëri Serbia, e atakoi. Po ashtu, ne kemi biseduar edhe për sigurinë në këtë Kuvend me një seancë të veçantë dhe kemi kërkuar qartë që strukturat e UNMIK-ut të largohen nga Republika e Kosovës ose të luajnë rolin e vet konstruktiv, sepse ata janë fasilitues të strukturave të MUP-it të Serbisë, janë të strukturave paralele serbe, të cilat jo që kanë interes për qytetarët serbë atje, por kanë interes për ta vazhduar jetëgjatësinë e tyre në një pjesë të territorit, i cili nuk është në kontrollin e institucioneve të Republikës sonë.

Ne kemi kërkuar që KFOR-i të adresojë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, në kufijtë e tërë Republikës së Kosovës të adresojë forcën e vet dhe prezencën e vet dhe në këtë mënyrë kishte ofruar mundësi që të krijojë kushte më të mira edhe për shërbime doganore, edhe për kontrollin e hyrjes së mallrave pa kontroll. Po ashtu, EULEX-i të jetë forcë ndihmëse përmbajtjesore e strukturave të policisë, të strukturave të rendit dhe të sigurisë së vendit tonë, që t'i fuqizojë në tërë territorin e Kosovës dhe me theks të veçantë në pikën 1 dhe në pikën 31.

Po ashtu, Qeveria dhe doganat kemi kërkuar që të aplikojë reciprocitetin, të implementojë marrëveshjen e Cefta-s, të ndalojë implementimin e mallrave. Kjo u bë para 3 ditësh dhe ne të gjithë jemi sot përkrahës dhe inkurajojmë Qeverinë që mos të tërhiqet për asnjë minutë, inkurajojmë KFOR-in dhe falënderojmë përjetësisht, sepse edhe ata nën komandimin gjermanë, amerikanë dhe francezë, me forca multinationale i treguan edhe një herë agresionit serbë se në Republikën e Kosovës po bëhet qasje që të forcohet demokracia, të shtrihet ligji, të forcohet rendi.

Ne duhet të jemi shumë të shqetësuar sot. Për 10 vite në Republikën e Kosovës janë qarkulluar mbi 7 miliardë euro mallra të pakontrolluara. Kush i ka pasur në dorë ato mallra? Kush, do të thotë, krimi i organizuar, që sot financojnë strukturat paralele që është një numër shumë i vogël dhe që nuk mund ta rrezikojnë sigurinë e vendit, janë një grup që nuk kanë ideal kombëtar as nacional për serbët, po kanë një grup i cili ka interes kriminal për ta mbajtur jetëgjatësinë e vet me strukturat e shtetit serbë.

Prandaj, sot në Këshillin e Sigurimit edhe Bashkimi Evropian, po edhe prezenca e ministrit tonë duhet qartë t'i adresohet se qasja që të pengohet funksionimi normal i pikave doganore është e qartë si në pikë të ditës, që të lejohet hyrja e mafies ekonomike dhe liderët lokalë, të cilët janë serbë që quhen vetë si struktura paralele, janë bosët e mafisë. Prandaj, EULEX-i, edhe në interpelancat e kaluara kam thënë që më mirë është të dislokohe në veri dhe të jetë i atashuar 24 orë në veri dhe të vendos, në bashkëpunim me strukturat tona, ligjin dhe rendin. Dhe për 200 persona që janë atje, nuk e shoh që Kosova të dorëzohet dhe të hyjë në një alert, duhet të jemi të kujdesshëm edhe mos të lejohen konfliktet ndërnacionale, siç kanë pasur interes në vitin 2004, sepse nuk janë në interes të

kombit tonë, nuk janë në interes të perspektivës së Kosovës. Konkluzionet të cilat ne i lexuam, besoj që janë të kapshme dhe i japin fuqi edhe Qeverisë dhe vendosmërisë së Qeverisë që të mos tërhiqet dhe në këtë mënyrë do të na e fuqizojë edhe votimin e popullatës e cila na ka sjellë në këtë Parlament që të garantojmë një shtetësi të qartë, një perspektivë të qartë të Republikës së Kosovës për ta integruar në strukturat evropatlantike. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Enis Kervan e ka fjalën! Nuk është!
Deputetja Alma Lama!

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Aksioni i Policisë së Kosovës për të vë nën kontroll pikat doganore 1 dhe 31, pas refuzimit nga ana e EULEX-it për të respektuar vendimin për reciprocitet me Serbinë, i marrë nga Qeveria e Kosovës, është i drejtë dhe i ligjshëm. Në fakt, kjo masë ka qenë kërkesa jonë e vazhdueshme. I toleruar për 12 vite, në mënyrë të pajustificueshme nga misionet ndërkombëtare, njëherë UNMIK e tani EULEX, veriu është bërë çështja më e vështirë dhe problematike për funksionimin e shtetit.

Të gjithë jemi të një mendimi se kjo gjendje nuk mund të tolerohet më tej, se shmangia siç ka ndodhur deri tani, jo vetëm që nuk e ka qetësuar dhe zgjidhur situatën, por vetëm sa e ka përkeqësuar, prandaj ky është një moment i përballjes dhe duhet të bëhet edhe moment i zgjidhjes së problemit.

Kauza jonë, megjithëse e vështirë, është e drejtë. Ne e mbështetëm fuqishëm aksionin e policisë dhe vendimin e Qeverisë për të respektuar Kushtetutën e vendit në të gjithë territorin, mirëpo pavarësisht përkrahjes, nuk mund të mos kritikojmë veprimet e policisë dhe Qeverisë në rast se ato nuk ishin të përgatitura mirë, të planifikuara mirë dhe të mos i ngjanin një iniciative të papjekur. Për fat të keq, të dhënat nga burimet në terren flasin për një aksion të cilit i ka munguar analizat paraprake të terrenit, të rriskut, planifikimi i ngjarjeve dhe strategjia e veprimit.

Kam mësuar se jo të gjitha njësitet e nevojshme për një ndërhyrje profesionale kanë qenë të planifikuara në terren. Në rastin e aksioneve të tilla është dashur të jenë njësi për intervenim, njësi për mbështetje, i cili ka qenë në bazë, pra në Shipol, njësi për tërheqje dhe natyrisht njësitetet e sigurimit anësor.

Nuk është e rastësishme që pikërisht mungesa e njësitit anësor ka bërë që plumbat të vinin nga të dy anët e rrugës dhe të shkaktonin shkëmbimin e zjarrit, i cili pati një kosto kaq të rëndë, siç ishte vrasja e policit të trupave speciale, Enver Zymberi, dhe unë shfrytëzoj rastin t'i shpreh ngushëllimet familjes së tij!

Vrasja e tij është bërë me snajper, gjë që na tregon se krimin e kanë kryer njerëz profesionistë, paramilitarë serbë, të cilët ishin vendosur në të dy anët e rrugës, nga kanë kaluar forcat speciale të Policisë së Kosovës, pra është më se e qartë se nuk ka pasur kontroll paraprak të terrenit, siç do të kishte bërë çdo polici serioze.

Nga ana tjetër, organizimi i serbëve në një periudhë tepër të shkurtër për të bllokuar rrugët dhe për t'u pozicionuar nëpër pikat nga kanë qëlluar, flet se ka pasur një dekonspirim të aksionit të Policisë së Kosovës, pra sekreti ka dal pa shkuar ende në pikat kufitare. Ndërsa ministri i Brendshëm zoti Bajram Rexhepi, duke folur në telefon për media, ka gabuar rënd kur ka dhënë shifrën prej 40 policësh, që kanë dërguar rreth 40 policë dhe një gabim tjetër gjithashtu është informacioni i dhënë prej tij se Policia është pozicionuar në Shipol. Këto janë të dhëna të cilat duhet të mbeten sekrete deri në fund të aksionit dhe të mos i jepet mundësi palës tjetër që të informohet.

Fatkeqësisht, kemi marrë vesh se trupat speciale të Policisë së Kosovës nuk kanë pasur pajisje të nevojshme për një aksion të tillë. Besoj, e keni parë se ata nuk kanë pasur as helmata në kokë. Po kështu, edhe makinat me të cilat kanë udhëtuar, nuk kanë qenë të gjitha të blinduara, por makina të thjeshta. Ndërsa kanë qenë vetëm 8 automjete të blinduara, tepër të pamjaftueshme për një aksion të tillë.

Qeverisë së Kosovës nuk mund t'i falet që nuk ka investuar në blerjen e pajisjeve të nevojshme për Policinë. Në vend të makinave të blinduara për policët dhe për aksionet e tilla të rrezikshme, këta kanë blerë makina për zyrtarë të lartë, makina shumë të shtrenjta, madje një ish zyrtar i lartë i Policisë ose kreu më i lartë i Policisë i pati blerë vetes një makinë prej 300.000 eurosh të blinduar. Kjo është një politikë e papërgjegjshme shtetërore. Kosova nuk ka ushtri të sajën, kështu që së paku është dashur të forcojë policinë.

Polici i ndjerë Enver Zymberi është vrarë pasi është dhënë urdhri që njësitë të shkonte për herë të dytë dhe të kalonte pikërisht andej nga ka pasur shkëmbim zjarri më parë dhe ku trupat e Policisë ia kishin dalë pra herën e parë që të tërhiqeshin pa ndonjë të vrarë.

Nga ana tjetër, është e pafalshme që trupat speciale nuk kanë pasur municion të mjaftueshëm. Ata janë kthyer në bazë me karikatorë të zbrazur.

Këto janë disa fakte të cilat flasin për një aksion jo të planifikuar mirë dhe me profesionalizëm dhe unë nuk pajtohem këtu me parafolësit që thonë që nuk ia vlen të bëjmë sot analiza. Analiza duhet të bëhen një orë e më parë.

Tash ne vijmë tek një çështje tjetër, ajo e djegies së pikave doganore. Pas shpalljes së pavarësisë, huliganët serbë bënë të njëjtën gjë në portën 1 dhe 31. Ka vetëm një arsye se pse u bë kjo në vitin 2008 dhe pse po bëhet tani, sepse ka të bëjë me milionat që fitohen nga kontrabanda.

Unë kam informacion dhe besoj se edhe policia e ka këtë informacion, se janë dhënë qindra mijëra euro nga njerëzit që merren me kontrabandë për t'i vënë flakën pikave doganore, në vitin 2008 flas.

Tolerimi prej 12 vjetësh i kësaj gjendjeje iu ka dhënë mundësi kriminelëve në veri që të forcohen dhe të bëhen të paprekshëm. Mirëpo, këta kriminelë serbë dhe që mbrëmë i

vunë flakën edhe pikës tjetër doganore, kanë bashkëpunëtorët e tyre edhe në jug të Mitrovicës. E këta bashkëpunëtorë janë shqiptarë dhe duhet ta themi me zë të lartë.

Me një hulumtim shumë të thjeshtë mund të gjesh emra të njerëzve që merren me kontrabandë në veri – në jug dhe që bëjnë që ky biznes të jetë i dëshiruar. Zoti Shaip Muja përmendi se kush janë, urdhëroni kush janë, janë këtu të gjithë në listë, mund t'i hulumtoni edhe më tej.

Këtu nuk e kam dhënë listën e kontrabanduesve serbë. Këta veprojnë në jug të Mitrovicës, fusin mallra kontrabandë në gjithë territorin, fitojnë miliona dhe nuk është pra çudi që janë të paprekshëm, sepse ata kanë blerë apo korruptuar një pjesë të policisë dhe drejtësisë në Kosovë, por unë nuk do ta lija me kaq, do të thosha se ka edhe parti politike apo eksponentë të tyre, të cilat ushqehen me para të krimit dhe të kontrabandës.

Nga ana tjetër, e falënderojmë shumë misionin EULEX që është i brengosur për gjendjen në veri, por i kujtoj këtij misioni se nuk është këtu për t'u brengosur, por është për të vepruar për vendosjen e sundimit të ligjit.

Për sa i përket bashkëpunimit me këtë mision, në lidhje me aksionin e ndërmarrë të hënën, po dëgjojmë deklarata kontradiktore. Kryeministri duhet të na shpjegojë nëse i është kërkuar bashkëpunimi apo jo. Por, gjithsesi sjellja e EULEX-it është e papranueshme në çfarëdo lloj rrethane. EULEX-i neutral ndaj statusit dhe ky është hendikep i tij më i madh, nuk mund të jetë neutral ndaj sundimit të ligjit, sepse atëherë edhe për çfarë është këtu?

Unë gjej rastin të kritikoj edhe KFOR-in për reagimin e ngadaltë dhe me të gjitha për faktin se gjatë këtyre 12 viteve në Kosovë asnjëherë nuk ka ndërmarrë një aksion në veri për kontroll armësh, gjë që e ka bërë këtë në pjesë të tjera të Kosovës.

Sot serbët në veri janë të armatosur, MUP-i i ka pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme dhe drejton aksionet e tyre kundër shtetit të Kosovës.

Përfundimisht, edhe pse sfidat janë të mëdha, asnjë lloj presioni që vjen nga terreni nuk duhet ta zbrapsë Policinë dhe Qeverinë e Kosovës nga vendimi për të zbatuar ligjin në tërë territorin dhe jo vetëm në pikat doganore, por edhe për kthimin e gjyqtarëve në veri, arrestimin e kriminelëve, shuarjen e strukturave paralele dhe vendosjen e rendit atje.

Sa për qytetarët e Kosovës, është shumë e rëndësishme që të ruajnë qetësinë, pasi çdo incident ndër etnik do ta komprometonte kauzën tonë të drejtë. Shteti ka institucione përgjegjëse për siguri dhe ato duhet të veprojnë, atëherë kur veprojnë ose në rast se janë duke vepruar me të vërtetë dhe jo për marketing politik.

Ndërsa, në fund, dua t'i bëj një pyetje zonjës Edita Tahiri, se si e shpjegon faktin se personi zyrtar që e ka dërguar Beogradi për të biseduar me turmat serbe dhe me komandantin e KFOR-it, është homologu i saj Borko Stefanoviq? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Enis Kervan e ka fjalën.

Faleminderit zotri kryetar,

Sayın Meclis Başkanı, sayın başbakan yardımcısı, sayın bakanlar, değerli milletvekilleri

Kosova Türk vekilleri olarak, Kosova Türk topluluğu adına öncelikle Kosova Cumhuriyeti kurumlarına, Kosova Hükümetine, kuzeydeki yasal eylemine yönelik çalışmalarına sonsuz destek sunduğumuzu belirtir, kurumlara yönelik inancımızı bir daha yenilemek isterim.

Kosova Cumhuriyeti'nin bağımsız ve egemen bir devlet olarak güçlenmesi tüm Kosova toplulukları olduğu gibi Kosova Türk topluluğun da temennisidir. Çünkü Kosovalı Türkler bu devletin yapıcı unsurlarıdır. Kosova'nın kuzeyinde dolayısıyla Kuzey Mitroviça'da yaşayan Türk, Arnavut, Boşnak, Sırp, Rom ve diğer toplulukların her yönüyle Kosova Cumhuriyeti kurumlarıyla bütünleşmesi kaçınılmazdır. Devletimizin sınırları bu çerçevede kuzeydeki 1. ve 31. sınır kapılarında Kosova Cumhuriyeti polis ve gümrükçüleri tarafından yönetilmesinin destekçisi olduğumuzu belirtmekte yarar görüyorum.

Ayrıca uluslararası faktörlerden AB'nden bundan böyle Kosova Cumhuriyeti egemenliğine ve bütünlüğüne yönelik daha net bir şekilde tüm toplulukların beklentileri doğrultusunda Kosova kurumlarına destek sunmalarını istemekteyiz.

Kosova'nın en genç kahramanı Enver Züberi'yi rahmetle anarken ailesine taziyelerimizi iletiyor, saygılarımı sunuyorum.

Faleminderit

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ramiz Lladrovci, e ka fjalën!

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Debati i sotëm në Kuvendin e Kosovës është një temë e pritur dhe për herë të parë po flasim këtu për një veprim të suksesshëm të institucioneve më të larta të vendit, shtrirjen e sovranitetit dhe kushtetutshmërisë edhe në veri të vendit.

Besoj se vendimi i Qeverisë së Kosovës për të ndërmarrë operacionin prej kthimit të kontrollit në pikat më të ndjeshme kufitare 1 dhe 31, ka qenë i qëlluar dhe duhet të përkrahjet nga të gjithë ne, ashtu sikur që kjo përkrahje nuk mungoi as për dy ditët e kaluara.

Me këtë operacion Republika e Kosovës për herë të parë tregoi fuqinë e shtetit në mbrojtje të tërësisë territoriale, të stabilitetit, të Kushtetutës, rendit dhe ligjit në të mirë të gjithë qytetarëve të saj.

Ky aksion i Policisë së Kosovës, i mbështetur edhe nga pjesëtarët e KFOR-it, duhet parë si veprim për të krijuar siguri në të gjithë vendin dhe për të gjithë qytetarët, pa dallim etnie. Ajo që nuk ndodhi për 12 vjet në Kosovë, ndodhi në dy ditët e kaluara. Ne duhet t'iu jemi mirënjohës të gjithë pjesëtarëve të Policisë së Kosovës që morën pjesë në aksion dhe atyre që ishin në gatishmëri, duhet t'i falënderojmë pjesëtarët e KFOR-it që u bënë pjesë mbështetëse e këtij operacioni për vendosjen e kontrollit në veri.

Mbi të gjitha, i themi edhe një herë: lavdi policit që dha jetën e tij për të mbrojtur kufirin, shtetin, Kushtetutën – Enver Zymberit!

Të nderuar kolegë deputetë,
Rruga dhe caku ynë është Evropa dhe integrimet evro-atlantike. Atje mund të shkojmë vetëm me çështje të zgjidhura e probleme të spastruara. Operacioni i fundit i Qeverisë së Kosovës e kishte këtë qëllim.

Fajtor i tërë kësaj është Beogradi, agresori është Beogradi, që përmes këtyre strukturave të shtetit represiv serb, siç e kam thënë edhe herëve tjera, se Serbia e ashtuquajtur demokratike e Tadiqit dhe e tadiqëve të tij, është po ajo Serbi e Millosheviqit dhe millosheviqëve, si Tadiq, Jeremiq, Stefanoviq e të tjerë, të cilët po e djegin veriun e Kosovës. Me këto veprime ata po e largojnë pajtimin ndëretnik të të dy popujve dhe shteteve tona.

Qeveria e Kosovës nuk synoi asgjë tjetër, pos vendosjes së rendit dhe ligjit, zbatimit të Kushtetutës edhe në atë pjesë të saj.

Mendoj se duhet t'i japim edhe një përkrahje të radhës Qeverisë së Kosovës në veprimet e mëtejme në këtë operacion, deri në vendosjes përfundimtare të rendit dhe ligjit në tërë territorin e saj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja Teuta Sahatqija e ka fjalën!

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryesues!

Mendoj që është mirë dhe ka qenë koha që të diskutohet për këtë temë, për këtë temë për një veprim i cili njëherë u duk veprim shumë i pa pritur, një temë të cilën populli e mirëpriti, të cilin politika e përkrahu, për të cilën policia tregoi që është në krye të detyrës dhe është e gatshme që të ballafaqohet, për një veprim i cili tregoi që së paku na dha shpresë, që më në fund do të arrihet respekti për Kushtetutën, për rendin dhe për ligjin.

Cilat ishin ndikimet që dolën prej kësaj? Serbia e angazhoi makinerinë shkatërruese me terroristë, të cilët janë të instaluar prej fillimit aty në veri. Në Këshillin e Sigurimit Serbia kërkon që të diskutohet, e në fakt do të duhej që të ishim ne ata me miqtë tanë që të kërkojmë dhe të akuzojmë Serbinë për vrasje, për djegie, për cenim të Kushtetutës. Do të

duhej të ishim ne që t'i tregojmë BE-së se me çfarë partneri kërkon që të arrijmë partneritet, me një Serbi e cila i nisi katër luftërat dhe e cila e ka të instaluar makinerinë shkatërruese, të cilën e angazhon sa herë që t'i nevojitet dhe e cila financon këta terroristë.

Me Borko Stefanoviqin, me të cilin ne po dialogojmë për çështje teknike, e pamë përsëri aty, po jo për dialog, po e pamë në përkrahje të terroristëve.

Por, hajde ta analizojmë kah aspekti tjetër, të analizojmë kah procedura, kah organizimi, a është me të vërtetë ajo shpresë reale të cilën ne menduam, të cilën po e presim, të cilën po kërkojmë të besojmë që është ashtu. A është marrja e pikave me të vërtetë marrja e pikave, a i kemi ne ato pika. A e kemi ne kontrollin në atë territor, a është vendosur reciprociteti sot në ato pika apo në veriun e Kosovës, a kemi reciprocitet. Apo a kemi ndonjë plan të cilin pasi që të kryhen veprimet emergjente, a kemi diçka e cila vazhdon, e cila do ta ruaj, e cila do të ketë vazhdimësi në ato pika, a i kemi doganierët tanë aty sot dhe kjo tregon që në organizim me të vërtetë ka shumë, shumë mangësi.

Nuk kryhen veprimet vetëm me veprime emergjente spektakulare, veprime të cilat kinse kozmetike tregojnë që jemi duke vepruar diçka. Po ato veprime Qeveria që i ndërmerr duhet të pasojnë me një plan, duhet të pasojnë me të vërtetë, duhet të pasojnë me kontrollin e plotë, me reciprocitetin e plotë, e jo vetëm me kozmetikë.

Ne dëshirojmë të besojmë që do të ketë diçka në vazhdim dhe që Kosova përveç këtij spektakli, do të arrijë ta ketë kontrollin e territorin e vet, që të mos nënkuptohet që është kjo vetëm tërheqje e vëmendjes prej veprimeve tjera të cilat po i ndërmerr EULEX-i në aspektet tjera, e të mos jetë vetëm ajo po të jetë me të vërtetë një veprim i paramenduar mirë.

Ne do ta përcjellim në vazhdimësi situatën dhe do të reagojmë ashtu si duhet për të mirën e Kosovës, për respektimin e Kushtetutës dhe për respektimin e rendit dhe të ligjit.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Flora Brovina e ka fjalën!

FLORA BROVINA: Përshëndetje të gjithëve!

Përgëzoj dhe inkurajoj Qeverinë, kryeministrin në veçanti për hapat e marrë për mbrojtjen e integritetit dhe të sovranitetit, të Kushtetutës dhe zbatimit të ligjit, kontrollit të pikave doganore, respektimit të reciprocitetit të këmbimit të mallrave dhe luftës kundër krimit.

Më lejoni që nga kjo foltore të shpreh ngushëllimet për familjen e Heroit të Kosovës, Enver Zymberi, i cili ra në krye të detyrës së shenjtë. Unë, deputetja më e vjetër e këtij Parlamenti, jam e sigurt se secili prej nesh do të sakrifikonte vetveten për sovranitetin e vendit sikurse Heroi Enver Zymberi.

Pajtohem se qetësia, matura dhe besimi në Qeverinë, në KFOR-in dhe në përkrahësit ndërkombëtarë në mbrojtje të sovranitetit dhe të integritetit të vendit tonë i ndihmon

momentit delikat dhe shton bindjen për pjekurinë, qëndrueshmërinë dhe maturinë qytetare në ndihmë të Qeverisë.

Fjalën time e morra për të ndikuar në nxjerrjen e Rezolutës, pasi kam një vërejtje. Mendoj se në rezolutë, në arsyetimin pse nxirret kjo rezolutë, pas fjalës: “duke u nisur nga parimet bazë të dokumenteve ndërkombëtare të Kosovës”, mendoj se duhet shtuar “dhe duke u mbështetur në mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shtetësi dhe pavarësi të Kosovës”, pasi që këtë mendim, këtë mendim që unë e quaj - tapi të Kosovës, nuk e shfrytëzojmë çdo herë dhe në çdo moment ashtu si duhet. Është momenti që t’ia shtojmë kësaj rezolute.

Ky mendim i Gjykatës Ndërkombëtare vërteton edhe obligimin tonë qytetarë dhe shtetëror ndaj vendit tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Liburn Aliu e ka fjalën!

LIBURN ALIU: Veprimi armiqësor i shtetit të Serbisë në Kosovës i ka pra dy aspekte të veta.

Përpos aspektit politik, që po e diskutojmë vazhdimisht dhe kundrejt të cilit sot po flasim në veçanti, është edhe aspekti tjetër, aspekti ekonomik. Pra, është pikërisht leverdia ekonomike ajo që Serbinë sot e bën të ketë sytë dhe interesin tejet të madh drejt Kosovës dhe janë ato 500 milionë euro që Serbia i eksporton në Kosovë e që kohëve të fundit Qeveria serbe i ka deklaruar, e që edhe kjo shifër tregon për shumën e madhe të madhe të kontrabanduar që bëhet në Kosovë, pra është pikërisht kjo shifër ajo e cila e mobilizon dhe e forcon Serbinë drejt Kosovës.

Leverdia e Serbisë, interesi i saj ekonomik, respektivisht të hollat, paratë që ajo i merr nga Kosova përmes eksportit, janë paratë me të cilat ajo pastaj i financon strukturat paralele dhe e forcon pozitën e vet destruktive brenda Kosovës, pra atë elementin tjetër për të cilin ne sot po flasim, elementin politik.

Strukturat paralele të Serbisë, në një anë mundësojnë destabilizimin e brendshëm të Kosovës, gjendjen e këtillë çfarë është dhe në anën tjetër krijojnë pasiguri tek qytetarët dhe e godasin drejtpërdrejt lirinë.

Dhe, në anën tjetër, janë pikërisht financat që Serbia i merr përmes Kosovës të cilat i mundësojnë dhe i financojnë këto struktura. Prandaj, reciprociteti, respektivisht bllokimi i mallrave të Serbisë është plotësisht i drejtë dhe është i kuptueshëm. Më tutje, ky bllokim do të duhej të shoqërohej edhe, të themi, me bojkotin e të gjithë tregtarëve në Kosovë ndaj mallrave të Serbisë e po ashtu edhe me bojkotin e qytetarëve në blerjen e këtyre produkteve të Serbisë.

Në vitin 2006, Lëvizja “Vetëvendosje” pati bërë thirrje për bojkot të produkteve të Serbisë dhe aso kohe për muajt në vijim, pas thirrjes së bojkotit, ndodhi një rënie shumë e madhe e importimit të këtyre mallrave, respektivisht të blerjes së mallrave serbe në

Kosovë. Kjo ndërmarrje atëherë u shoqërua menjëherë me një fushatë dampingu me mallra tejet të lira në Kosovë, pasi që Serbia ishte shumë e vetëdijshme për dëmin që mund t'i sillte një bojkot.

Dhe, po e shfrytëzoj rastin tani nga kjo foltore, për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe për tregtarët që t'i bojkotojnë mallrat e shtetit armik të Serbisë, pasi që paratë të cilat i merr Serbia nga Kosova përmes këtyre mallrave, Kosovës po i kthehen me plumba drejt policëve të saj, drejt lirisë së saj. Që t'i ndalim këta plumba, ne duhet t'ia ndalim edhe financimin atyre strukturave paralele përmes blerjes së mallrave serbe që ne e bëjmë.

Po ashtu, i bëj thirrje Bashkimit Evropian që Serbisë së këtillë, Serbisë e cila drejtpërdrejt ndërhyt dhe e dëmton lirinë dhe e pengon lirinë e një populli, të mos ia jep kurrsesi statusin e shtetit kandidat për në BE. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Xhevahire Izmaqi!

XHEVAHIRE IZMAQI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Më lejoni që nga kjo foltore këtu që tani të bashkëndjej dhembje me familjarët e dëshmorit dhe heroit tonë të ri, të bashkëndjej dhe të ndaj krenarinë dhe dhimbjen me ta për rënien e tij dhe për veprën e tij heroike.

Si deputete e këtij Kuvendi, përshëndes vendimin e madh të kryeministrit tonë për shtrirjen e autoritetit shtetëror edhe në veriun e Kosovës. Sot dhe dy ditë, më shumë se kurrë e ndjeva unitetin e munguar të gjithë spektrit politik, emocionin e besimit të madh për të kurajuar organet e rendit, për të kurajuar Qeverinë e Kosovës me rastin e ushtrimit të autoritetit shtetëror.

Kushtetuta e vendit tonë u materializua dhe gjithë ne, në secilin pozicion, si qytetarë, politikanë e shprehëm gatishmërinë të qëndrojmë afër institucioneve tona në këtë proces.

Qytetarët tanë, në gjithë vendin duhet të marrin mesazhin e drejtë të kryeministrit dhe Qeverisë dhe të besojnë fuqishëm tek Qeveria dhe institucionet tona, tek strategjia e saj dhe mos të harrojmë që ne vazhdojmë të jemi partner i fuqishëm i aleatëve tanë të para luftës, gjatë luftës dhe pas luftës.

Duke besuar se uniteti i treguar deri sot do të mbijetojë në gjithë spektrin politik deri në realizimin e plotë të planit shtetëror, deri në shtrirjen e plotë të autoritetit tonë në gjithë vendin, më lejoni që të shpreh admirimin tim për gjithë këtë punë të madhe që organizoi dhe kreu ministri i jonë Rexhepi, gjithashtu kam një porosi, ministër, herën tjetër planet strategjike ndoshta duhet t'i diskutosh edhe me Grupin jo formal të Grave, por unë shpreh admirimin tim edhe për praninë tënde fizike deri në fund në veri deri në kryerjen e planit operativ. Faleminderit!

KRYESUSESI: Faleminderit! Deputeti Anton Çuni e ka fjalën!

ANTON ÇUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Nuk dua të përsëris atë që u tha nga parafolësit, sidomos për çështjet e politikbërjes për situatën e krijuar, por më shumë do të fokusohem për çështjet e mekanizmave të ekzekutimit të politikave.

Jemi të vetëdijshëm se opinioni është i fokusuar me një vëmendje të veçantë në Policinë e Kosovës dhe ndihmën që e ofrojnë trupat e KFOR-it. Policia e Kosovës për të parën herë po e realizon një operacion kompleks dhe fillimisht janë përgjegjësit kryesor për realizimin e objektivit, siç është vënia nën kontroll e kalimeve kufitare 1 dhe 31.

Policia e Kosovës është angazhuar në një ambient armiqësor brenda Kosovës. Përkundër të gjitha përgatitjeve dhe parashikimeve, krijohen situata të reja dhe të panjohura ndaj të cilave duhet reaguar në mënyrë adekuate.

Angazhimi i Policisë së Kosovës është shans e cila nuk përsëritet për shprehjen e qëndrimit të vendosur për implementimin e ligjit dhe rendit në tërë territorin e Kosovës dhe funksionalizimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Drejtuesit e operacionit në këtë situatë duhet të kenë parasysh skenarët e përgatitur në Beograd nga ekspertët në fushën e inteligjencës, të policisë dhe ushtrisë, por që në terren paraqiten si reagime spontane të qytetarëve serbë, studentëve, nxënësve, të miturve e tjerë, të cilët në tërë vandalizmin dhe huliganizmin e tyre paraqiten kinse si viktima.

Policia e Kosovës për t'u përballur me një situatë të tillë, duhet të ketë urdhra dhe instruksione të qarta dhe deri në detaje të përpunuara procedurat standarde operative dhe të drejtat e angazhimit. Për arritjen e suksesit të operacionit do të ishte e pafalshme që njësitë e Policisë së Kosovës të dërgohen të pa përgatitura në aspektin taktik, pajisjeve teknike policore dhe pa mbështetje logjistike.

Përkundër motivimit dhe gatishmërisë së lartë të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës për t'u treguar në nivelin e detyrës, duhet të jenë të kujdesshëm për masat maksimale të sigurisë për vetveten, por edhe për minimizimin e dëmeve kolaterale të cilat, po të ndodhin, do të propagandohen fuqishëm nga Beogradi me qëllim të degradimit të shoqërisë së Kosovës, të institucioneve të saj dhe posaçërisht në degradimin e institucioneve të sigurisë së Republikës së Kosovës.

Përfundimisht, insistojmë në profesionalizmin e lartë të Policisë së Kosovës dhe njëkohësisht në humanizmin e saj si tregues të kulturës, të qytetërimit dhe të aspiratave të qytetarëve të Kosovës për vlera demokratike dhe civilizuese. Dhe, po ashtu, që njësitet e Policisë së Kosovës dhe të Doganës së Kosovës të gëzojnë mbështetjen e pa rezervë të Qeverisë së Kosovës, si përgjegjëse kryesore për menaxhimin dhe tejkalimin e situatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Poštovani predsedavajući,

Uvažene gospode Vlade,

Poštovani deputeti,

Jedna mlada država, kao što je Republika Kosovo, može graditi moderno, demokratsko i multietničko društvo samo ako tu nema mesta nasilju, konfliktu, međuetničkoj netrpeljivosti, nepoštovanju vladavine prava i ustava.

U ime Bošnjačke zajednice, dajem podršku kosovskim institucijama, Vladi Kosova, međunarodnim bezbedonosnim snagama da istraju u vezi suzbijanja ovog problema na graničnom delu između dve zemlje Kosova i Srbije i da se više nijednoj porodici, bez obzira na nacionalnu opredeljenost, ne desi slučaj porodice Zymberi.

Upućujem apel Vladi Kosova da malo više obrati pažnju na pogranična sela u opštini Leposavić, gde u velikom broju žive pripadnici Bošnjačke nacionalne zajednice, koji su jako uznemireni i uplašeni u vezi aktualnih dešavanja i događaja.

Takođe, zahtevam od Vlade i institucije Kosova da malo više obrate pažnju na položaj Bošnjaka u Bošnjačkoj mahali i na celokupnoj teritoriji opštine Mitrovica. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Gëzim Kelmendi e ka fjalën!

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Situata aktuale në veriun e Kosovës na bën të kuptojmë se sundimi i ligjit dhe siguria në Kosovë është e cenuar dhe e rrezikuar për qytetarët e Kosovës.

Nuk është hera e parë që digjen pikat doganore të Kosovës dhe kur synohet që të vihet rendi dhe sundimi i ligjit në gjithë territorin e Kosovës, gjegjësisht respektimi i Kushtetutës në tërë territorin e Kosovës, kemi akte të tilla terroriste dhe kriminale të organizuara nga bandat kriminale serbe.

Vrasja e policit Enver Zymberi, plagosja e policëve të tjerë, si dhe terrorizimi i objekteve dhe institucioneve të Kosovës janë të papranueshme dhe duhet të marrin dënimin e duhur dhe të merituar.

Kryeministri i Kosovës deklaroi se më nuk ka kthim prapa, në parim dhe nuk do të duhej të ketë kthim prapa dhe, përveç asaj, duhet që Policia e Kosovës së bashku me KFOR-in dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë të merr përsipër një detyrë e cila përcillet po ashtu me vështirësi, demilitarizimin e atyre bandave kriminale në veri të Kosovës, të cilat paraqesin rrezik për gjithë qytetarët e Kosovës.

Ajo çka ka ndodhur në ditët e shkuara, nuk bën të harrohet dhe të tejkalohet. Vrasja e Enverit nuk është vetëm vrasje e një polici të njësive elite të Kosovës, por është vrasje ndaj institucioneve të Kosovës, vrasje ndaj sundimit të ligjit dhe sigurisë në Kosovë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne duke e votuar këtë rezolutë që e kemi para veti dhe e sigurojmë mbështetjen e institucionit të Kosovës, unë propozoj që si deputetë dhe ne si përfaqësues të popullit të solidarizohemi me familjen Zymberi, kërkojmë dhe propozoj që Kryesia e Kuvendit, në bashkëpunim me shefat e grupeve parlamentare të harmonizojë që së paku një përqindje nga paga jonë mujore të dedikohet për familjen Zymberi ngase, siç e dimë, polici i ndjerë ka lënë pas veti tre fëmijë dhe bashkëshorten. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Fillimisht, më lejoni që të shpreh ngushëllimet më të përzemërta për policin e vrarë, zotin Enver Zymberi!

Më lejoni që të përshëndes aktin e lartë të Policisë së Republikës së Kosovës, të cilët kanë kryer punën e tyre me profesionalizëm dhe dinjitet të lartë, duke ruajtur gjakftohësinë dhe profesionalizmin.

Gjithashtu, më lejoni që si deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës të shpreh mirënjohjen time personale, po edhe të gjithë votuesve dhe të popullit të Kosovës, për forcat e KFOR-it të cilat me angazhimin e tyre maksimal po dëshmojnë me punën e tyre për ruajtjen e kufijve të Kosovës.

Unë personalisht dua të inkurajoj kryeministrin e Kosovës që për herë të parë në Kosovë ndodhi një veprim i duhur dhe një kryeministër i këtij shteti u soll ashtu dhe veproi ashtu siç duhet të sillen burrshtetasit e Kosovës.

Kryeministri i Republikës së Kosovës për herë të parë dëshmoi që në këtë vend ka një Kushtetutë dhe duhet të respektohen ligjet dhe Kushtetuta e Kosovës.

Evropa dhe bota duhet ta dijë qartë se shteti i Kosovës është ngopur me kompromiset që janë bërë për 12 vite rresht dhe tani ka ardhur koha që t'i japim fund lojës së bandave kriminale, të cilat luajnë me djallëzitë e tyre para hundës së shtetit të Kosovës.

Më bën të ndihem çuditshëm ose thjeshtë më çuditë fakti me indiferencën e EULEX-it në Kosovë, të cilët gjatë gjithë kohës dhe në çdo moment gojën e kanë plotë drejtësi dhe respektim të ligjit, ndërsa me një indiferencë të tillë dhe me një ftohtësi të tillë sillen kundër ligjeve të Kosovës dhe kundër mbrojtjes së Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar qytetarë të Kosovës,
Jemi dëshmitarë të gjithë që dje policit të vrarë Enver Zymberit iu dha dekorata Heroi i Kosovës, por duhet ta kemi të qartë se dekorata më e mirë për Enverin dhe fëmijët e Enverit, të cilët sot jetojnë pa kulm mbi kokë në Kosovë, është mbrojtja e territorit të Kosovës dhe e kufijve të saj, për çka inkurajoj Qeverinë e Kosovës që për asnjë moment të mos zbrapset nga pozicionet e tyre dhe me maturi të marrin nën kontroll pikën 1 dhe 31 dhe të mbrojnë kufijtë e Kosovës në çdo anë dhe në çdo cep.

Të dashur qytetarë,
Mbështes Deklaratën e kryeministrit të Kosovës në thirrjen për unitet dhe qetësi. Kosova sot ka më shumë nevojë se kurrë që të ketë unitet politik dhe qytetar dhe gjithashtu më lejoni që t'i përsëndes të gjithë qytetarët e Kosovës që me maturi dhe vëmendje të lartë po e presin çdo vendim dhe çdo zhvillim që bën Qeveria e Kosovës.

Më vjen keq dhe nuk dua që sot ta shfrytëzoj këtë mikrofon ose këtë foltore për inate personale ose urrejtje, por më çudit fakti i deputetes ose parafolëses time, Alma Lama, kur kritikon veprimet e KFOR-it, që gjëja janë të ngadalshme, kur ne jemi dëshmitarë të gjithë për punën që po e bën KFOR-i në veri të Kosovës. Dhe, kam frikë, e nderuara Alma, që deri në fund të mandatit nuk do të kesh ku të kapesht diku tjetër dhe të kritikosh dhe do ta kritikosh edhe vetë zotin që e ka krijuar botën. Faleminderit!

KRYESUESI: Replikë, Alma Lama, deputete!

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!
Dua t'i them parafolëses që nuk e ka kuptuar aspak atë që thashë unë.

KFOR-i dhe çdo institucion tjetër nuk është i pa kritikueshëm, atëherë kur nuk e kryen punën si duhet.

Unë thashë, KFOR-i nuk ka bërë kontrolle për armët në veri. Do të duhej ta kishte bërë. E ka bërë në pjesë të tjera të Kosovës. Në veri nuk ka guxuar asnjëherë. Nuk e mohon askush kontributin e KFOR-it gjatë këtyre viteve në Kosovë, por le t'i kuptojmë gjërat ashtu siç thuhet. Është dashur që veriu të çarmatoset. Kjo ishte ideja ime. Faleminderit!

KRYESUESI: Kundërreplikë, deputetja Musliu! Regjia!

GANIMETE MUSLIU: Më vjen keq se nuk mundem ende të dimë se çfarë njeriu ka në kokë dhe mendon, por ne gjithmonë mund të flasim për atë çka thuhet dhe këtu në këtë seancë u tha që kritikojnë KFOR-in për veprime të ngadalshme. Kaq kisha!

KRYESUESI: Faleminderit! Sa për informatë, Alma nuk e di a keni qenë këtu, KFOR-i ka pas filluar kontrollin, çarmatosjen e veriut. Por, nga jugu ka pasur protesta dhe është ndërprerë në gjysmë dhe më s'ka pasur ndonjë aksion të tillë. Fjalën e ka deputeti Florin Krasniqi!

FLORIN KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit,

Një sugjerim për Qeverinë e ndoshta ata nuk do ta marrin sugjerimin tim si deputet të Kuvendit, po unë e kisha ftuar ministrin e Rendit dhe Policinë që kompetencat rreth hetuesisë për vrasjen e policit dhe për plagosjen e policëve tjerë t'i marrin vetë Policia e Kosovës. Mos t'ia lënë në kompetenca të EULEX-it.

Është shumë me rëndësi se hetuesia dhe ndjekja e këtyre kriminelëve të bëhet prej autoriteteve vendore. Dhe në qoftë se kjo mbetet në kompetencën e EULEX-it, do të mbetet vetëm në letër, hetimet do të vazhdojnë, deri sa EULEX-i do të shkojë dhe kriminelët do të jenë të lirë.

Sugjerimi im i dytë ose propozimi im i dytë është për Kryesinë e Kuvendit. Mendoj se është koha që Kryesia e Kuvendit të thërret një seancë të jashtëzakonshme, me dyer të mbyllura, ku gazetarët nuk do të ishin prezentë dhe monitoruesit nuk do të ishin prezentë dhe stafi s'do të ishte prezent.

Në këtë seancë të jashtëzakonshme, sugjeroj që të ftohen Presidentja e vendit, drejtori i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, drejtori i Policisë në qoftë se ka, komandanti i FSK-së, Këshilli i Lartë i Sigurisë, në qoftë se ekziston.

Mendoj se një seancë me dyer të mbyllura, ku ne si deputetë dhe përfaqësues të popullit nuk do të bënim marketing politik, por do të ishim konstruktiv, e sidomos në këtë moment kur ka njëfarë uniteti politik rreth zgjidhjes së situatës dhe krijimit të tërësisë territoriale të vendit, kishte qenë shumë me rëndësi një seancë e jashtëzakonshme, kur ne do të dilnim me konkluzione konkrete, pa marketing politik, edhe një herë po them, dhe mendoj se edhe forcat e Policisë, FSK-ja dhe gjithë akterët e sigurisë në Kosovë do të ndjehen më mirë kur ne në një seancë me dyer të mbyllura do të mbërrinim unitet gjithëkombëtar dhe do të kishim mbështetje.

Mendoj se të gjithë e dimë se edhe pse po përpiqemi të mos bëjmë marketing politik, e arsyëja pse unë nuk do t'i jap vërejtjet e mia për kohën, mënyrën, metodën, se janë të shumta rreth asaj çka ka ndodhur, po për hir të unitetit politik, për hir të mbështetjes së atyre që janë në vi të frontit sot dhe rrezikojnë jetën e tyre, unë nuk do t'i bëjë këto vërejtje. Këto vërejtje do t'i bëj vetëm atëherë kur do të bëhet një seancë me dyer të mbyllura dhe ne si deputetë do t'i sqarojmë shumicën e gjërave pa marketing politik.

Faleminderit shumë dhe ftoj për një unitet të tillë politik deri sa Kosova gjendet në këtë situatë të jashtëzakonshme, edhe pse shumë deputetë këtu thanë se nuk është e jashtëzakonshme, vetë niveli çfarë është KFOR-i, niveli i gatishmërisë më të lartë të KFOR-it dhe të shtetit serb tregon se ne jemi në gjendje të jashtëzakonshme dhe duhet të veprojmë si të tillë. Ne jemi në gjendje të jashtëzakonshme, shteti i Kosovës duhet të veprojë unik dhe i përbashkët për të mbrojtur tërësinë territoriale të vendit. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, e ka fjalën! Dua t'ju njoftoj juve drejtuesve të grupeve parlamentare që janë edhe 4 deputetë dhe mirë është që t'i ftoni deputetët për ta votuar pastaj rezolutën, në qoftë se kanë arritur marrëveshje kryetarët e grupeve.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kërkoj që në këto momente, kur po bëhen hapa të domosdoshëm për vënien e sovranitetit në tërë territorin e vendit, me çka po i jepet një goditje strukturave kriminale, të kontrabandës, krimit të organizuar, të udhëhequr nga Qeveria e Beogradit përmes strukturave paralele dhe të balancuara nga ajo që ne vërtet të rezonojmë dhe të jemi unikë.

Ne si subjekte politike apeloj të rezonojmë drejtë dhe të unifikuar për interes të vendit, të tejkalojmë divergjencat, mos të tentohet të fitohen poenë politike me situatën nga se interesi i Kosovës është më i madh se i çdo subjekti politik.

Djegia dje e portës 1 dhe mbajtja e saj për afër një orë nën kontroll nga strukturat paralele serbe, dëshmoi qartë se Serbia qëndron prapa këtyre akteve të dhunës dhe krimit të organizuar në atë pjesë. Pika 31 është nën kontrollin e Doganave të Kosovës, të Policisë së Kosovës e përkrahur nga KFOR-i dhe nuk duhet manipuluar me këtë.

Situatën duhet analizuar në tërësi. MUP-i serb, bashkë me strukturat paralele ka urdhëruar dje qytetarët serbë të mbyllin dyqanet në ora 15 dhe të mobilizohen të gjithë, qytetarët serbë.

Fatbardhësisht, qytetarët serbë, malazezë dhe boshnjakë të asaj pjese nuk iu përgjigjen ftesës së MUP-it serb. Ata që pamë dje në rrugë, ishin pjesëtarë të MUP-it dhe strukturave paralele. Qytetarët serbë janë të lodhur nga këto struktura dhe ata dëshirojnë të inkuadrohen në institucionet e Kosovës dhe janë për rend dhe për ligj. Andaj, kërkojmë që organet e rendit, Policia e Kosovës, bashkë me KFOR-in, shpresoj edhe EULEX-in, të ndalojnë dhe arrestojnë të gjithë pjesëtarët e MUP-it dhe të strukturave paralele që veprojnë në Kosovë me emër e mbiemër, kriminelë të identifikuar tani e 12 vjet, të cilët udhëheqin edhe krimin e organizuar në atë pjesë.

Thirrjet sot për mobilizim të përgjithshëm dhe luftë qytetare nuk ndihmojnë situatën, kur Policia jonë, KFOR-i dhe Doganat janë në nivelin e detyrës dhe kanë besim të plotë në dhe guximin e tyre, nga se ata edhe dëshmuar me vepër këtë.

Sot duhet të ftojme qytetarët për qetësi dhe jo involvim në strukturat ilegale dhe besimin në institucionet tona, policinë tonë, por besim edhe në strukturat e sigurisë ndërkombëtare, në KFOR-in, ngase tani jemi shtet dhe duhet të veprojmë si shtet dhe po veprojmë si shtet dhe çdo njeri të kryejë përgjegjësinë që i takon. Dhe nuk ka kthim mbrapa. Kthimi mbrapa është kthim në krim të organizuar dhe në terror qytetar në atë

pjesë. Thirrje sot për mobilizim qytetarë, janë thirrje për anarki. Ua kujtoj se ftesa për mobilizim nga 16 deri në 65 vjeç ka qenë në vitin 1998 dhe 1999, kur kemi qenë në luftë për liri dhe bërje të shtetit. Kush ka dashur iu ka përgjigjur. Nuk është sot koha për mobilizim qytetar, por për veprim shtetëror dhe ne duhet si Parlament t'i japim mbështetje Qeverisë në këtë veprim kushtetues.

Edhe një herë ju ftoj për unitet në këta hapa të shtetndërtimit, andaj edhe i kam dy propozime:

Propozoj që dekorata në policinë e Kosovës për profesionalizëm, guxim dhe trimëri të quhet me emrin të Heroit të Kosovës, policit Hero Enver Zymberi.

Propozimi i dytë, për shkak të ndjeshmërisë së situatës në pikat 1 dhe 31, atje të vendosen doganierët e Kosovës, Policia kufitare dhe Policia regjionale e Kosovës, e mbështetur nga institucionet ndërkombëtare, KFOR-i dhe nëse e ka gatishmërinë që të jetë në nivelin e detyrës, edhe policia e EULEX-it.

Dhe, në fund, dua të falënderoj të gjithë policët që vendosën dhe po ruajnë kushtetutshmërinë e vendit me guximin dhe profesionalizimin e tyre, po edhe dua të falënderoj edhe ushtarët e KFOR-it që mbështetën këtë veprim të Policisë së Kosovës. Falënderoj të gjithë qytetarët shqiptarë që ruajtën trojet e veta dhe që qe 12 vjet u përballën me këto struktura kriminele, e të cilët edhe në këto momente të rënda ruajtën qetësinë dhe ruajtën trojet e tyre pa u involvuar në situata të tilla dhe patën besim në shtetin tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Sadri Ferati e ka fjalën!

SADRI FERATI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pra, unë po besoj se asnjë prej neve nuk jemi të befasuar me gjithë rrjedhën ngjarjeve. Më vjen mirë që të gjithë deputetët ndajnë mendimin se i gjithë ky aktivitet ka qenë legjitim, legal dhe është lidhur me zbatimin e vendimeve të Qeverisë në territorin e saj. Pra, në këtë rast, në zbatimin e vendimeve të Qeverisë në territorin e saj, pra, në këtë rast në zbatimin e reciprocitetit. Por e gjithë ajo që ka pasuar pastaj, besoj se nuk është ndonjë befasi dhe nuk është hera e parë që Beogradi sillet kësisoj. Dhe, po të marrim një analizë që nga vitet 90 gjithmonë atëherë kur Beogradi nuk ka pasur të drejtë një ide dhe forma e sjelljes së tij ka qenë sjellja e një polici këtu në Ballkan, gjithmonë e fundit që e ka përdorur ka qenë krijimi i pasojave mbi një betejë të humbur. Dhe, gjithë kjo që tani ne po e shohim në Kosovë, pra nuk lidhet me një perspektivë, nuk lidhet me ndonjë ide ose strategji për dalje nga kjo situatë për krijimin e sa më shumë pasojave.

Vetë fakti se ne kemi atje qytetarë të cilët janë plotësisht të armatosur dhe gjithmonë reagojnë në thirrjet publike apo jo publike që iu bëhen, ngase saktësisht dihet edhe vendi nga aktivizohen sirenat e ndryshme ku ata grumbullohen, saktësisht dihet emri dhe

mbiemri i personave që ata i udhëheqin dhe ne sot kemi situatën që Beogradi distancohet nga ajo dhunë të cilën e ka nxitur dhe e ka organizuar.

Megjithatë, ne duhet t'i bëjmë detyrat tona si shtet, si shoqëri kosovare, prandaj edhe një herë, kjo mbështetje e Parlamentit për veprimet, detyrimet dhe përgjegjësitë që i ka Qeveria, shpresojmë se do të veprojë me një qetësi institucionale, me një pragmatizëm maksimal dhe me gjitha veprimet mirë të planifikuara, mirë të koordinuara, me gjithë akterët të cilët mund t'i shërbejnë kësaj ideje, por njëkohësisht duhet të ketë edhe një aktivitet të fuqishëm ndërkombëtar për të komprometuar këto sjellje të Beogradit, ngase se të tjerët për arsye të ndryshme mund të mendojnë ndryshe, por ne kemi të drejtë të themi se kjo sjellje e Beogradit nuk dallon nga sjelljet e 78-tave, të 12-tave, të 19-tave dhe në këtë drejtim duhet të mos ta nënçmojmë që të punojmë shumë edhe në aspektin e prezantimit ndërkombëtar të kësaj situatë.

Ndërsa, të shpresojmë se ne nuk do të hasim më tutje në vazhdimin e aktiviteteve dhe në zbatimin e Kushtetutës dhe të ligjit të Kosovës, por asnjëherë nuk duhet të befasohemi dhe të sillemi sikur e tash, ne e pamë këtë që ndodhi, nga se vërtet vetëm ata që nuk e njohin peshën e veriut, përndryshe do ta kuptojnë drejt. Dhe të gjitha veprimet e mëtejme dhe të Qeverisë, dhe të Parlamentit duhet të jenë sistematike dhe të mos shpresohet se me një akt situata në vijë do të tejkalohet. Por, prandaj jemi këtu të gjithë bashkë, që secili ta japim kontributin tonë në mënyrë që shteti i Kosovës dhe i qytetari i Kosovës, ta ndërtojë perspektiven e vet ashtu siç e sheh ai, normalisht, gjithmonë në bashkëpunim me miqtë dhe dashamirët e këtij vendi dhe të interesit të qytetarëve. Ju faleminderit!

Drejtimin e mbledhjes e merr zoti Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Visar Ymeri e ka fjalën, le të përgatitet Zenun Pajaziti.

VISAR YMERI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

E mora fjalën këtu që shkurtimisht t'i vë në pah dhe t'i bëj të dukshme disa përputhje deklarative të cilat i patëm ne si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës deri tash, por që janë përputhje deklarative, prapë po e përsëris, edhe me ato që i thanë kryeministri Hashim Thaçi sot në seancë, dje në deklarimet e tij publike, por edhe deputetët tjerë, qofshin edhe të pozitës dhe opozitës.

Pra, po i tërheq vëmendje të tri deklarimeve kryesore që për mendimin tim kanë rëndësi dhe të cilat e shpërfaqin edhe këtë përputhje deklarative dhe pastaj bashkë ta shohim se si do të duhej të përputheshin tash këto fjalët tona që po i themi këtu në Kuvend, me veprimet institucionale të shtetit të Kosovës, për shkak se, po qe se nuk përputhen fjalët tona me veprimet e institucioneve shtetërore, atëherë kjo ndikon apo e shënjon një lloj, të them ashtu, skizofrenie institucionale, e cila fatkeqësisht është duke u bartur prej vitit në vit në institucionet e Kosovës.

Pra, kryeministri Hashim Thaçi, e dëgjuam të gjithë se tha që bandat kriminale, të cilat e sulmuan apo i sulmuan pikat doganore, pikat kufitare mes të Kosovës dhe Serbisë, janë të dirigjuara nga Serbia dhe janë të planifikuara dhe të nxitura nga Serbia. Pra, kjo nënkupton asgjë tjetër, përveç se ne jemi sulmuar nga Serbia. Tash sulmi mund të marrë forma të ndryshme, natyrisht, herë bëhet me ushtri, herë bëhet me polici e herë bëhet me policë civilë, siç ndodhi ky sulmi i fundit kundër shtetit të Kosovës. Dhe kur ka sulm nga jashtë atëherë natyrisht që institucionet duhet të mendojnë dhe të veprojnë karshi këtij sulmi. Pra, cili është ky veprim karshi këtij sulmi, gjëja e parë që duhet të ndodhë dhe që shkruhet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është se duhet të shpallet gjendja e jashtëzakonshme? Nuk ka arsye më të fuqishme dhe më të madhe për ta shpallur gjendjen e jashtëzakonshme në një vend se sa sulmi nga jashtë.

Pra, nëse pajtohemi se këto janë forca apo janë struktura të organizuara të Serbisë, të cilat fatkeqësisht po veprojnë në territorin e Kosovës, prej vitit 1999 dhe nëse pajtohemi se ato na i sulmuan institucionet shtetërore, atëherë natyrisht që duhet të pajtohemi që ky paska qenë sulm nga Serbia, dhe të veprojmë sipas këtij sulmi ose karshi këtij sulmi nga Serbia.

Po e them edhe një herë, prandaj Lëvizja “Vetëvendosje” insistoi që në fillim të kësaj seance që të mos kemi seancë dhe të aktrojmë si Kuvend thua ti çdo gjë është normale, për shkak se kjo është një situatë jo normale. Karshi një situatë jo normale, të vepruarit e vetëm normal është që edhe ne të sillemi karshi asaj situatë jo normale. Dhe, pra në këto rrethana të krijuara tash në Kosovë, situata e vetme apo përgjigja e vetme dhe e para më e rëndësishmja që duhet ta bëjnë institucionet e Kosovës, është që ta konsiderojnë situatën të jashtëzakonshme dhe ta mobilizojmë veten si institucione, por edhe shoqërinë e Kosovës, karshi kësaj situatë të jashtëzakonshme. Pra, të kalojmë në modusin e jashtëzakonshëm të veprimit secili prej nesh e veçanërisht ne kolektivisht si institucione, si shoqëri.

Çështja e dytë që dua ta ngre, është deklarimi tjetër i kryeministrit Hashim Thaçi, i cili tha se këto, apo sulmet që u kryen kundër institucioneve të Kosovës në pjesën veriore të vendit dhe sulmi i vazhdueshëm që i bëhet atje sovranitetit të vendit apo të Republikës së Kosovës, bëhet nga mbeturinat e Millosheviqit. Dhe prapë po pajtohemi, në Qeverinë e Republikës së Serbisë ka shumë mbeturina të Millosheviqit, po çka është edhe më e keqe në Qeverinë e Republikës së Serbisë, sot vazhdon të jetojë mendësia politike e Millosheviqit.

Pra, karshi Kosovës, karshi shqiptarëve kjo politikë e Tadiqit e edhe më herët e Koshtunicës, nuk dallon fare nga ajo e Millosheviqit.

Varësisht rrethanave të krijuara në skenën ndërkombëtare, qeveritë e Serbisë kanë për të përdorur metoda të ndryshme kundër Kosovës, mirëpo qëllimi politik ka qenë përherë i njëjtë dhe është mendësia politike e Millosheviqit ajo që po na sulmon neve edhe sot, dhe e millosheviqëve para tij.

Dhe, meqenëse është kështu, atëherë çfarë kuptimi ka ky përkushtim i Qeverisë së Kosovës për ta vazhduar dialogun me mbeturinat dhe mendësinë politike të

Milloseviqit, se kur ka qenë Milloseviqi në pushtet, populli i Kosovës nuk ka negociuar me të? Pse tash po e ndryshojmë këtë?

Prandaj, Lëvizja “Vetëvendosje”, në kërkesën e vet të vazhdueshme që e bëri edhe sot, është që të kërkohet ndërprerja e menjëhershme e dialogut, negociatave me Serbinë, për shkak se jemi duke negociuar dhe duke bërë kompromise, duke i lëshuar pe një politike e cila synimin e vet kryesor e ka zhbërjen e shqiptarëve nga Kosova. Këtë e dimë të gjithë, dhe me këtë po pajtohem të gjithë.

Prandaj, ftesa ime është që të veprojmë në bazë të asaj që po pajtohem, në bazë të atyre fjalëve që po i themi.

Dhe, çështja e tretë, e cila u ngrit këtu, edhe nga kryeministri, është marrëdhënia me EULEX-in. Pra, kryeministri i Republikës së Kosovës, edhe sot në seancën e jashtëzakonshme të këtij Kuvendi, por edhe dje në deklaratimet e veta publike, përfshirë edhe deklaratimin e vet në mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, tha që EULEX-i nuk na ka ndihmuar, pra EULEX-i ka refuzuar që të veprojë sipas vendimeve të Qeverisë së Kosovës.

Kjo nuk është aspak e çuditshme dhe e habitshme, për shkak se natyrisht që EULEX-i, meqenëse është neutral karshi statusit të Kosovës dhe meqenëse është pushtet ekzekutiv i cili emërohet nga jashtë dhe nuk jep kurrfarë llogarie kurrfarë institucioni të Kosovës, atëherë ai e ka politikën e vet dhe nuk vepron sipas vendimeve të Qeverisë së Kosovës dhe këtu duhet të veprojë Qeveria e Kosovës.

Prandaj, ne thërrasim që të merren masat dhe Republika e Kosovës të fillojë diskutime menjëherë me Brukselin për ta përfunduar misionin e EULEX-it dhe për të ridefinuar praninë e BE-së në Kosovë, për shkak se nuk mund të presim nga një mision i cili nuk na njeh neve si shtet, i cili konsideron se shteti i pavarur i Kosovës nuk ekziston fare, pra është neutral karshi tij, që pastaj, pas këtij qëndrimi politik të tij të veprojë dhe të veprojë për ta mbrojtur shtetin e Kosovës.

EULEX-i nuk do ta bashkojë pjesën veriore të Kosovës me pjesën tjetër të Kosovës dhe EULEX-i nuk do t'i mbrojë pikat kufitare të Kosovës. Atë duhet ta bëjmë ne, duhet ta bëjnë institucionet tona.

Për sa i përket mobilizimit dhe ftesës për mobilizim, unë mendoj që këtu qëllimisht po shtrembërohet dhe po keqkuptohet kjo ftesë. Pra, duhet ta dimë që format dhe mënyrat e mobilizimit ndryshojnë, varësisht prej rrethanave në të cilat ato thirren dhe merren. Një shoqëri dhe një shtet që i mban qytetarët dhe institucionet të mobilizuara, gjithsesi se ka më shumë sukses se sa ajo shoqëri apo ai shtet dhe ajo qeveri e cila kërkon nga qytetarët që të mos brengosen për situatën e vet. Çka ndodhë me Kosovën është përgjegjësi e secilit qytetar dhe ka të bëjë me jetën e secilit qytetar, prandaj secili qytetar i Kosovës duhet të jetë i brengosur dhe është i brengosur në gjendjen aktuale, për atë se çfarë po ndodhë.

Po ashtu shkalla e mobilizimit institucional e shoqëror, ndryshon. Dhe, kjo shkallë duhet ngritur tash në përputhje me gjendjen e jashtëzakonshme e cila duhet të shpallet dhe e cila po mbretëron në vendin tonë. Dhe, rrjedhimisht, po qe se duam vërtet të jemi në krye të detyrës, siç ishte në krye të detyrës njësi special, apo njësitet speciale të Policisë së Kosovës, atëherë ne si institucione duhet doemos që të insistojmë dhe ta shpallim gjendjen e jashtëzakonshme dhe të veprimet sipas saj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti, le të përgatitet deputeti Afrim Hoti!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,

Mbase kjo seancë është e përcjell edhe me dhimbjen tonë për policin e vrarë, tashmë heroin e shpallur dhe me shqetësimin për ata burra e gra që këto ditë janë dhe do të jenë në krye të detyrës në ruajtje të kufirit dhe në sundimin e ligjit në gjithë territorin e Kosovës. Debati i sotëm na shërben po ashtu që të gjithë më shumë të mobilizohemi në kryerjen e detyrave tona të përditshme, në mënyrë që të kemi sukses gjithandej në forcimin e institucioneve të Republikës së Kosovës.

Ajo që ndodhi këto ditë, ishte në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe me dokumentin e strategjisë së sigurisë kombëtare. Vendimi i Qeverisë i shpallur nga kryeministri për hapat në pikat kufitare është në përputhje të plotë me këto dokumente dhe po ashtu kjo vë në pah edhe veprimet e tjera të Këshillit për Siguri Kombëtare që këto ditë besoj do të mbledhet dhe të japë edhe rekomandime shtesë për institucionet dhe qytetarët e Kosovës. Veprimet ose vendime të këtij organi do të jenë të nevojshme për institucionet dhe ato janë legjitime, ata do të vendosin se është gjendje e jashtëzakonshme apo duhet të bëhen veprime të caktuara në situatën e caktuar.

Ajo që mendoj nuk u tha këtu, e që duhet të përmendet, është që këto veprime të institucioneve të Kosovës dhe të Policisë janë në përputhje të plotë me planin veprues për partneritet evropian, një plan i cili është i përqafuar nga të gjitha institucionet e Kosovës.

Ju e dini që mbi kokë ka vite që na rrinë disa sfida që kanë të bëjnë me menaxhimin e integruar të kufirit dhe ka kohë që nuk kemi mbështetje të mjaftueshme nga institucionet të cilat e kanë marrë mandatin për ta menaxhuar kufirin në këto dy pika, pra në veri të vendit.

Ajo që ndodhi tash, është një vendosmëri e shtuar e institucioneve për të vepruar dhe po ashtu një adresim i qartë i lëshimeve të atyre që kanë pasur mandatin dhe nuk kanë mbështetur institucionet vendore në sundimin e ligjit atje.

Ajo çka vërehet tash dhe që duhet të trajtohet me seriozitet nga të gjithë ne është një unitet politik i cili duhet të shfrytëzohet në funksionimin sa më të mirë të institucioneve në zbatimin e ligjit jo vetëm në veri, po gjithandej Kosovës, në të gjitha fushat e jetës. Nuk duhet të harrohet agjenda e integriteteve evropiane, sfidat që janë në përmbushje dhe të cilat nuk duhet të harrohen për asnjë moment, edhe pse kjo që po ndodh këtyre ditëve

është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe jashtëzakonisht na tërheq që të jemi të përqendruar atje.

Nuk na duhet eufori në asnjë moment. Ajo po ashtu që duhet të mos harrohet, është komuniteti pakicë serb. Ne duhet t'ia bëjmë me dije këtij komuniteti që këto veprime nuk janë në dëm të këtij komuniteti. Veprimet në menaxhimin e kufirit janë për sigurinë dhe të mirën e të gjithë qytetarëve, pa dallim ashtu siç u tha edhe nga vetë kryeministri dhe megjithatë nuk duhet të lihet hapësirë për manipulime në asnjë moment.

Është adresuar disa herë EULEX-i dhe me të drejtë ky mision i cili është kërkuar nga vetë institucionet e Kosovës dhe është mirëpritur atëherë kur është dashur të ndërrohet një mision tjetër që ka qenë gati se i dështuar nga stërzgjatja e tij dhe nga mos puna, duhet të kemi kujdes po ashtu që në retorikën tonë për integrimet dhe partneritetin me BE-në, mos të harrojmë se ka një numër të madh institucioneve të BE-së që e mbështesin vendin tonë në procesin e ndërtimit, në procesin e shtetndërtimit dhe integritetit në BE. Prandaj, unë pajtohem plotësisht që institucionet tona duhet ta marrin rolin e vet që iu takon dhe po ashtu duhet të rishikohet partneriteti me EULEX.

Duhet po ashtu të mendohet mirë këto ditë, nëse ka nevojë shtesë për mbështetje të institucioneve të sundimit të ligjit, veçanërisht të sundimit të ligjit dhe do të kishte qenë shumë inkurajuese për gjithë ne dhe institucionet dhe qytetarët që të silleshin para drejtësisë të gjithë ata që kanë shkaktuar dhunë dhe po shkaktojnë dhunë atje dhe sidomos vrasësit, vrasësi i policit.

Ne gjithandej duhet të tregojmë këtë vendosmëri tonën në solidaritetin tonë dhe në punën tonë të përditshme. Ne duhet t'u japim shan çdo ditë qytetarëve tanë që të kenë sa më shumë heronj të punës, heronj të zhvillimit të Kosovës, heronj të paqes, heronj të njerëzve që dinë të sillen si evropianë. Ajo që u adresua këto ditë dhe duhet të adresohet më shumë te miqtë tanë ose të informohen, është veprimi i njëanshëm i Serbisë, i Beogradit. Ata po e bëjnë të turpërohen gjeneratën e vet të re dhe vetëm pas disa vitesh do të shohin se të pakuptimta janë ato veprime që po i bëjnë ata, sepse vetë principet evropiane për menaxhimin e kufijve janë diçka tjetër dhe vetë principet evropiane për ardhmërinë e shteteve të Evropës janë krejt diçka tjetër. Ajo që po shihet sot, e dirigjuar nga Beogradi, po e them, po e bën të turpërohet vetë gjenerata e re serbe. Faleminderit!

KRYETARI: Deri pak më parë, ishte vetëm Afrim Hoti, tash janë shtuar edhe tre të tjerë. Deputeti Afrim Hoti e ka fjalën! Veç, mundësisht, i rumbullakoni fjalët!

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Tema e veriut është edhe e vjetër edhe e re. E vjetër sepse ka 12 vjet që është problem më i madh që ka Kosova, e re, sepse kjo temë nuk u zgjidh asnjëherë.

Unë mendoj se asnjëherë nuk ka pasur vullnet për t'u zgjidhur. Institucionet e Kosovës që pas luftës kanë qenë të paafta nuk kanë kërkuar dhe as bërë presion të mjaftueshëm tek UNMIK-u, KFOR-i e EULEX-i të cilat kanë qenë përgjegjësit e drejtpërdrejt. E kemi

thënë disa herë, dhe po e përsërisim, misionet ndërkombëtare këtu nuk janë për ta zgjidhë situatën por për ta mbajtur nën kontroll që të mos eskalojë më tutje.

Qeveria e Kosovës është dashur me kohë të reagojë, po më mirë vonë se kurrë, thotë populli. Tani jemi para një gjendje të jashtëzakonshme në veri. Bandat serbe me mbështetjen politike të Beogradit po dëshmojnë se janë shumë të vendosur për të mos u dorëzuar. Ata janë të vendosur sepse gjatë gjithë këtyre viteve kanë parë vetëm një Qeveri të pa vendosur, një KFOR të pavendosur, një UNMIK dhe EULEX të pa vendosur. Ato banda nuk janë njerëz të thjeshtë po janë pjesëtarë të MUP-it që udhëhiqen hapur prej kryetarëve të komunave paralele, të emëruar nga Beogradi zyrtar.

Na vjen mirë që dëgjojmë sot nga kryeministri se këtë herë është i vendosur. Urojmë të jetë kështu me të vërtetë dhe urojmë që kjo fushatë të mos ketë filluar për ndonjë arsye tjetër që lidhet me marketing politik.

Ne e kemi fatin që populli dhe policët janë të gatshëm të sakrifikojnë edhe më tepër për këtë vullnet, por duhet të ketë edhe Qeveria interesin e saj. Ne si popull kemi paguar çmim të shtrenjtë për lirinë. Çmim i lartë ishte edhe jeta e policit të vrarë. Por liria nuk është e përfunduar pa e vënë nën kontroll edhe Mitrovicën dhe tre komunat tjera në veri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Hamza Balje e ka fjalën!

HAMZA BALJE: Zahvaljujem, predsedniče!

Kolege zastupnici,

Još jednom bih hteo da u ime Bošnjačke zajednice i moje lično ime dam punu podršku Vladi i premijeru da istraju u svojoj odluci u ispunjavanju reciprociteta i očuvanju teritorijalnog integriteta Republike Kosova, zadajući tako odlučujući udarac naoružanim bandama sa sjevera Kosova.

Ovom akcijom dato je na znanje onima koji ne poštuju Ustav i zakon Republike Kosova, ne poštuju osnovne ljudske vrednosti i koji se bave organizovanim kriminalom da je došlo vreme sprovođenja zakona na celoj teritoriji Republike Kosova.

Prilikom sprovođenja ove akcije, tragično je izgubio život pripadnik Specijalne jedinice Enver Zymberi, koji je svojom pogibijom postao narodni heroj i potvrdio da je kosovski narod, bez obzira na vjeru i naciju, spreman da odbrani ustavnost naše mlade države.

Još jednom izražavam zabrinutost zbog nestabilnog stanja Bošnjaka na sjeveru Kosova i tražim od naših institucija Kosova da zaštite ovo stanovništvo. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Petar Miletic e ka fjalën!

PETAR MILETIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Uvaženi članovi Vlade,

Poštovane kolegice i poštovane kolege poslanici,

Samostalna liberalna stranka je izuzetno zabrinuta zbog događaja koji su se desili poslednjih dana na severu Kosova.

Pozivamo sve relevantne političke i bezbednosne faktore na suzdržavanje od nasilja, na mir i nastavak dijaloga, jer nasilje nikome neće doneti dobro i naš je jasan stav da dijalog nema alternativu.

Želim da ponovim zvaničan stav Samostalne liberalne stranke da je odluka o policijskoj akciji doneta bez konsultacija sa članovima Vlade iz naše stranke i poslanika iz Parlamentarne grupe Samostalne liberalne stranke i da zbog toga izražavamo protest, jer se odluka direktno tiče srpske zajednice.

Samostalna liberalna stranka je član vladajuće koalicije i kao odgovorni ljudi želimo da institucije Kosova funkcionišu, posebno u ovako osetljivom trenutku i u tom smislu želimo da damo svoj doprinos. Međutim, moramo biti informisani i konsultovani za sve odluke Vlade i Skupštine Kosova, posebno za one koje se direktno tiču srpske zajednice.

Takođe želimo da osudimo vandalsko paljenje u Jarinju, jer samo doprinosi nasilju i ne bezbednosti svih građana i daljem komplikovanju situacije.

Najveći gubitnik poslednjih dešavanja je policajac Enver Zymberi, koji je izgubio život i Samostalna liberalna stranka koristi priliku da sa ovog mesta izrazimo saučešće porodici ubijenog policajaca.

Pozivamo predsednika Vlade i ministra Unutrašnjih poslova da doprinesu smirivanju situacije kako se ne bi dogodilo da nasilje eskalira i zahvati i druge delove Kosova. Jer, na žalost, događaji koji su se dogodili juče i jutros u opštini Štrpce, ne idu u prilog smirivanju situacije.

Na kraju, želim da izrazim zahvalnost predstavnicima KFOR- i EULEX-a na požrtvovanom zalaganju kako bi se ponovo uspostavio mir i kako bi se ljudi vratili svojim svakodnevnim aktivnostima.

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Dhe i fundit i lajmëruar për sot, nëse nuk vazhdojnë të lajmërohen të tjerë, është deputeti Berat Buzhala!

BERAT BUZHALA: I nderuar zoti kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Filloi mirë dhe po përfundon mirë, por besoj nuk e kam mendjen ta prish këtë harmoni e cila ishte e admirueshme prej të gjitha grupeve parlamentare. Aksioni i cili u ndërmor nga ana e Policisë së Kosovës, përveç efekteve tjera pati edhe një efekt të jashtëzakonshëm. Kredibiliteti i Policisë së Kosovës falë, nganjëherë edhe me fajin tonë, filloi të goditej kohëve të fundit, duke tentuar që të ngjyrosej me ngjyra politike. Mirëpo, këtë herë, njësitë ROSU dhe Shërbimi Policor i Kosovës, apo Policia e Kosovës, tregoi që janë të popullit të Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne jemi vend i vogël dhe nganjëherë është vështirë të krahasohemi me vende të mëdha, mirëpo ma krahaso intervenimin e forcave SILL të Bashkuar të Amerikës, kur vranë kryeterroristin Bin Laden. Ne, këtë kaçik e kemi. Ne e kemi këtë mundësi. Aksioni i forcave ROSU e ngriti shkallën e patriotizmit dhe të vetëdijes qytetare. Secila nënë që e ka pasur fëmijën polic atë ditë ka qenë e solidarizuar me ata djemtë që kanë qenë atje, secila nënë që e ka pasur fëmijën doganier kanë qenë të solidarizuar me ata djem që kanë qenë atje.

Prandaj, në këtë moment kritik dhe jashtëzakonisht të rëndësishëm ne duhet ta mbajmë gjallë. Dihet se si filloi i gjithë aksioni. Aksioni ishte i koordinuar dhe ishte jashtëzakonisht mirë i menduar edhe prej Qeverisë së Kosovës. U shty deri në fund mundësia e dialogut me palën serbe, pala serbe u tërhoq prej dialogut, nuk i pranoi vullat doganore të Republikës së Kosovës dhe aty Qeveria reagoi jashtëzakonisht mirë me masat e reciprocitetit. Masat e reciprocitetit nuk u respektuan dhe kështu filloi aksioni në pjesën veriore të Kosovës për ta implementuar vendimin e Qeverisë. Qeveria e Kosovës do ta bënte një gabim katastrofal nëse tash, në këtë moment, ne zmbrapsemi dhe nuk e realizojmë implementimin e planit të reciprocitetit. Nëse kjo ndodhë atëherë me radhë do të duhej të vinin të gjitha çështjet tjera që na kanë mbetur të ngrira në pjesën veriore, siç është funksionalizimi i Gjykatës së Qarkut, siç është shuarja e strukturave paralele.

U përmend këtu prej kolegëve deputetë me kontrabandën që është realizuar në atë pjesë të Kosovës ka pasur një derivim të miliona eurove në duar të banditëve dhe kriminelëve, të cilët mandej e kanë mbajtur peng situatën.

A duhet të vazhdohet me dialog a jo? Kjo është një çështje interesante, mirëpo unë po mendoj edhe një herë: sikur të mos ishin shtjerë kushtet e dialogut, sikur të mos ishte shtjerë mundësia e dialogut me palën serbe dhe kjo ndërhyrje e forcave tona të ishte realizuar në veri pa u provuar dialogu ne do të merrnim flakaresh prej flakareshi prej bashkësisë ndërkombëtare. Mirëpo, lexoni edhe mediat, lexoni edhe gazetën “The Economist”, lexoni të gjitha mediat tjera, të cilat kanë shkruar që pala kosovare, pa fajin e saj, është ndalur dialogu. Dhe, në këtë rast nuk i ka mbetur rrugë tjetër Qeverisë së Kosovës pos ta implementojë dhe ta respektojë Kushtetutën e vendit.

Unë mendoj që dialogu në krye me zëvendëskryeministren Edita Tahiri duhet të vazhdojë, por jo të dorëzohemi në dialog. Ne mund t’i themi jo sa herë që ka nevojë Serbisë dhe të vazhdojmë politikën në respektimin e rendit kushtetues në shtetin tonë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Do të thotë të lajmëruar për diskutim s’kemi. Edhe nga Qeveria s’kemi më të interesuar për të marrë fjalën. Atëherë fjalën po ia jap Adem Grabovcit.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Fillimisht, dua t'i përshëndes dhe falënderoj të gjithë kolegët për mendimet e tyre, vërejtjet dhe sugjerimet që na i dhanë për ta plotësuar, korrigjuar rezolutën të cilën e diskutuam me të gjitha grupet – me shefat e grupeve parlamentare dhe u dakorduam të nxjerrim këtë rezolutë, e të cilën do ta lexoj në vijim.

Duke u nisur nga neni 2.2 dhe 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nga neni 6.1 i Rregullores së Kuvendit,

Duke nisur nga e drejta e institucioneve për ushtrimin e kontrollit efektiv në tërë territorin e Republikën e Kosovës,

Duke u nisur nga parimet bazë të dokumenteve ndërkombëtare për Kosovën,

Duke u nisur kah e drejta e shteteve sovrane për kontroll të kufijve të vet,

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën e datës 28 korrik 2011, nxjerr këtë:

R E Z O L U T Ë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, mbështet të drejtën kushtetuese të institucioneve për ushtrimin e kontrollit të plotë në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon që të respektohen masat e reciprocitetit me Serbinë në të gjitha pikat doganore.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës fton bashkësinë ndërkombëtare për t'i përkrahur institucionet e vendit në vendosjen e rendit dhe ligjit në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës u bën thirrje të gjithë qytetarëve, pa asnjë dallim, që ta ruajnë qetësinë, rendin kushtetues dhe sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.
5. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria të vazhdojë me angazhimin e saj për vendosjen e autoritetit kushtetues në pikat kufitare 1 dhe 31 dhe ndërmarrjen e veprimeve të tjera për shtrirjen dhe ushtrimin e sovranitetit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, i ftoj të gjithë deputetët që ta votojmë këtë rezolutë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Prezentë kemi 96 deputetë. Tani e kemi procedurën e votimit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, dhe votojmë për Rezolutën që e

mbështet Qeverinë për ta ushtruar kontrollin kushtetues, ose kontrollin e saj të plotë në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 89 vota “për”, 8 “kundër”, asnjë “abstenim”... Pa kartela, kush është “për”? 3 vota “për”.

Atëherë, 89 vota “për”, 8 “kundër”, asnjë “abstenim”, Kuvendi miratoi Rezolutën!

(Reagim)

A pati “kundër” pa kartelë?

Pra, kemi 89 vota “për”, 9 vota “kundër”, duke i përfshirë edhe ata që kanë pasur kartelë, edhe ata që s’kanë pasur kartela dhe me këtë Kuvendi miratoi Rezolutën.

Tani po e caktojmë një pauzë dhe në orën 15:30 vazhdojmë seancën e rregullt.

Përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë e Kuvendit të Kosovës